

1 E martë, 16 shkurt 2021

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur
7 të gjithë në dhomë dhe jashtë dhomës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, paraqitni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është çështja KSC-BC-2020-
10 06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
11 Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani do t'u lutesha palëve dhe pjesëmarrësve të
14 prezantoheshin, duke filluar nga Zyra e Prokurorisë.

15 Znj. Prokurore.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

17 Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar Jack Smith, Prokuror i
18 Specializuar; Alan Tieger, Prokuror i Lartë; David Harbach,
19 prokuror; Marlene Haage, punonjëse ligjore; dhe unë jam Clare
20 Lawson, kryetare e Zyrës Juridike.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

22 Tani po i drejtohem Mbrojtjes. Ju lutem mbrojtësve të
23 prezantohen, duke filluar nga z. Hooper, ju lutem.

24 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes, i
25 nderuar Gjykatës. David Hooper që sot ndihmohem nga Dastid Pallaska

1 dhe Sophie Menegon.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

3 Z. Emerson, të lutem.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes, i
5 nderuar, dhe të gjithë të tjerëve. Jam Ben Emerson që përfaqësoj
6 Kadri Veselin.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Young, të lutem.

9 Nuk e keni hapur mikrofonin. Ju lutem z. Young, hapeni.

10 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Më dëgjoni tani?

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit. David
13 Young, përfaqësoj Rexhep Selimin bashkë me Geoffery Roberts.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

15 Znj. Alagendra.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes i
17 nderuar Gjykatës. Përfaqësoj z. Jakup Krasniqi bashkë me Aidan
18 Ellis dhe z. Beqiri.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Po vë re se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi nuk
21 janë të pranishëm fizikisht në këtë sallë por e ndjekin me anë të
22 videokonferencës.

23 Dhe tani Administrata. Z. Roche.

24 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes. Shefi i Shërbimeve Ligjore
25 dhe i Zyrës së Administratës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roche.

2 Unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake për
3 këtë çështje.

4 Përpara sesa të vazhdoj me programin, po iu kujtoj palëve se
5 në qoftë se ju që e ndiqni me videokonferencë hasni në ndonjë
6 vështirësi teknike, ju lutem na njoftoni menjëherë mua dhe
7 sekretaren duke na e bërë me dorë. Dhe në qoftë se lidhja me ndonjë
8 nga pjesëmarrësit nuk funksionon, do të bëjmë ç'është e mundur që
9 të lidhemi sa më shpejt. Në qoftë se çështja nuk zgjidhet
10 menjëherë, mund të më duhet ta ndërpres seancën që të sigurojmë që
11 të rilidhemi.

12 Dhe tani kalojmë në historinë procedurale të çështjes.

13 Më 3 dhe 9 shkurt 2021, unë parashikova këtë Konferencë të
14 tretë për Statusin. Ju kërkoj palëve të ofrojnë -- të bëjnë
15 parashtrimet me shkrim, në qoftë se kanë dëshirë, për nxjerrjen e
16 materialeve, për përkthimin e përshkrimit në bazë të rregullës
17 86(3)(b), grafikun apo tabelën në bazë të rregullës 109(c),
18 statusin e hetimeve të Mbrojtjes, të Prokurorisë, pikat e pajtimit
19 për çështje ligji dhe fakti, datën e konferencës tjetër, dhe ndonjë
20 çështje tjetër që dëshironi të ngrini.

21 Më 8 shkurt, të hënën, ZPS-ja dhe Zyra e Administratës kanë
22 parashtruar vëzhgimet e tyre, parashtrimet e tyre, dhe ekipet e
23 Mbrojtjes gjithashtu kanë parashtruar të tyret më 10 shkurt. I
24 falënderoj palët për këtë.

25 Qëllimi i sotëm është të shqyrtojmë ecurinë e çështjes dhe të

1 diskutojmë temat që unë sapo i përmenda. I ftoj palët të paraqesin
2 pikëpamjet e tyre shkurtimisht për secilën nga pikat. U kujtoj
3 palëve të japin njoftim paraprak nëse ndonjë prej parashtrimeve të
4 tyre kërkon nxjerrjen e informacionit konfidencial.

5 Tani i ftoj palët që të ndjekim agjendën e parashikuar për
6 këtë konferencë. Do të filloj së pari me çështjen e nxjerrjes së
7 materialeve.

8 Dua, së pari, të dëgjoj nga Prokuroria për ecurinë lidhur me
9 nxjerrjen e materialeve provuese në lidhje me rregullën 102(1)(a),
10 nëse detyrimet për nxjerrje janë plotësuar sikurse e keni
11 parashikuar në parashtrimet tuaja me shkrim. Në lidhje me rregullën
12 102(1)(b), sa material mbetet akoma për t'u nxjerrë dhe nëse ZPS-ja
13 parashikon kërkesa për masa mbrojtëse.

14 Gjithashtu, dëshiroj që ZPS-ja të informojë Gjykatën nëse
15 mbeten prova shfajësuese në pronësi të tyre, apo në kontrollin,
16 dijeninë e tyre, dhe nëse ky material kërkon masa mbrojtëse në bazë
17 të një vendimi gjyqësor, dhe nëse parashikon ndonjë vështirësi
18 lidhur me procesin e nxjerrjes, sidomos në lidhje me materialet e
19 rregullës 107.

20 Dhe së fundi, i kërkoj ZPS-së t'i përgjigjet pikave të
21 ngritura nga z. Hooper në parashtrimet e tyre, lidhur me
22 identifikimin e dëshmitarëve dhe të materialeve të lidhura me
23 secilin prej tyre.

24 Znj. Prokurore, keni fjalën.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 Në lidhje me rregullën 102(1)(a), konfirmoj se materialet e
2 fundit janë nxjerrë më 12 shkurt me paketën 21 dhe pra, materialet
3 në bazë të rregullës 102(1)(a) janë nxjerrë të gjitha.

4 Që nga konferenca e fundit, ZPS-ja ka nxjerrë dy grupe
5 materialesh në bazë të rregullës 102(1)(b), dhe këto janë paketat
6 16 dhe 22. Gjithashtu, më 5 shkurt neve parashtuam një kërkesë për
7 masa mbrojtëse në lidhje me disa artikuj të tjerë lidhur me
8 rregullën 102(1)(b). Siç është vënë në dukje në parashtimin tonë,
9 materialet në bazë të rregullës 102(1)(b), po punohen në mënyrë
10 sistematike. Kanë mbetur dhe disa dhe do të bëhen disa nxjerrje të
11 tjera në javët dhe muajt e ardhshëm në përputhje me Vendimin
12 Kuadër.

13 ZPS-ja vazhdon të përmbushë detyrimet e veta sipas rregullës
14 103 në lidhje me materialet shfajësuese, kohët e fundit në paketën
15 20 të bërë të njohur më 11 shkurt. Ne po përgatisim nxjerrjen e
16 materialeve të tjera në bazë të rregullës 103.

17 Parashikohet që disa prej këtyre materialeve mund të kërkojnë
18 masa mbrojtëse. Dhe presim që të ndodhë kështu, edhe pse në këtë
19 moment nuk mund të them diçka konkrete.

20 Në lidhje me materialet e rregullës 107, diskutimi me disa
21 ofrues informacioni po vazhdon dhe është një fushë ku ne po
22 punojmë. Siç kemi thënë në parashtimet tona lidhur me një prej
23 këtyre organizatave, diskutimet tona po arrijnë përfundimin dhe ne
24 parashikojmë që kërkesën -- do të bëjmë një kërkesë në bazë të
25 rregullës 107.

1 Gjithashtu, meqë na e dhatë mundësinë, dua të trajtoj disa nga
2 çështjet e ngritura nga Mbrojtja e z. Thaçi.

3 Në lidhje me identifikim e dëshmitarëve, caktimi i një numri
4 personash është diçka që ndodh si pjesë e hetimit tonë si Zyrë
5 Prokurorie. Nuk është përcaktuar nëse ne do t'i përdorim këta
6 persona në gjyq, por të gjitha materialet e nxjerra në bazë të
7 rregullës 102(1)(a), janë materiale që ne i kemi përdorur në rastin
8 e konfirmimit të aktakuzës dhe, siç kemi thënë më përpara,
9 parashikohet që shumica e madhe e këtyre dëshmitarëve do të
10 përdoren për gjyq.

11 Në lidhje me kërkesën që të japim listën e dëshmitarëve, javën
12 e ardhshme besoj ishte data e parashikuar. Dua të them se jemi në
13 proces. Dëshmitarët dhe provat e tyre që ne do të përdorim, do t'i
14 bëjmë të njohura kur të vijë momenti i duhur sipas parashikimeve të
15 Vendimit Kuadër.

16 Për materialet e lidhura me tre dëshmitarë, ZPS-ja i është
17 përgjigjur kësaj pyetjeje midis palëve. Për të ndihmuar të gjithë
18 ekipet e Mbrojtjes ne e bëmë dhe njëherë të njohur materialin, në
19 bazë të rregullës 102, për të lehtësuar procesin e identifikimit.

20 Mbrojtja e Thaçit konstaton më tej se disa prova të treguara
21 dëshmitarëve gjatë intervistave, nuk janë bërë të njohura. Kjo
22 është e vërtetë. Ajo që është nxjerrë deri tani, janë materiale që
23 mbështesin aktakuzën dhe dokumentet fillestare në bazë të rregullës
24 102(1)(b). Dokumente të tjera që mund t'i jenë treguar dëshmitarëve
25 gjatë intervistave, do të nxirren në momentin e duhur në përputhje

1 me afatet e Vendimit Kuadër.

2 Konstatohet gjithsesi, se lidhja e disa dokumenteve mund të
3 implikojë vendime për masat mbrojtëse aktuale apo të ardhshme
4 lidhur me lidhjen e disa dokumenteve me dëshmitarët. Prandaj,
5 lidhja e dokumenteve me dëshmitarët është një proces që do të bëhet
6 gradualisht.

7 Së fundi, lidhur me parashtimet për fushat përkatëse jam
8 përgjigjur në konferencën e mëparshme. Pa dhënë shpjegime të tjera,
9 të njëjtët shembuj metadatash janë përsëritur. Unë vura në dukje në
10 dhjetor se ZPS-ja është e gatshme të diskutojë çdo pyetje lidhur me
11 metadata të cilat mund të duket të paqarta. Deri tani nuk na janë
12 bërë pyetje të tilla.

13 Prandaj po e përsëris që të dhënat fillestare që tregojnë
14 prejardhjen e dokumenteve, nga ku ne i kemi marrë këto dokumente,
15 nuk ka asnjë ndërmjetës apo një dokument të fshehur. Ne jemi të
16 gatshëm t'i përgjigjemi çdo kërkesë në këtë drejtim.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Tani i kthehem Mbrojtjes.

19 Z. Hooper, keni fjalën.

20 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
21 nderuar Gjykatës.

22 Siç thashë në fillim, unë do t'i kërkoj Sophie Menegon që të
23 trajtojë këto çështje. Kur them "çështje", e kam fjalën për ato që
24 ju ngritët në urdhrin tuaj. Ka një grup çështjesh të lidhura duke
25 filluar nga pika 1 deri te -- mbase te përkthimi, deri te -- pa

1 diskutim deri te rregulla 3 -- jo, rregulla 109(c), më falni, dhe
2 nënndarjet që lidhen me të.

3 Në lidhje me nxjerrjen e materialeve ka pasur disa vështirësi
4 konkrete, të cilat kryesisht janë trajtuar nga ZPS-ja kur u vunë në
5 dukje. Por mbetet ai që unë e quaj problem të përgjithshëm, dhe
6 është ky: Mënyra sesi sistemi me anë të të cilit ZPS-ja nxjerr
7 materialet, nuk është -- ka qenë i dobishëm.

8 Bile mund të them se nga sistemet e nxjerrjes së materialeve
9 me të cilët ne kemi punuar në gjykata, tribunale të tjerë, ky
10 sistem këtu është më pak i dobishmi. Dhe ky është një problem,
11 sepse sigurisht mënyra sesi bëhet nxjerrja, zbulimi i materialeve
12 dhe ndihma që mund të marrësh nga materiale të tillë, sidomos kur
13 bëhet fjalë për materiale të shumta siç i kemi këtu, ky sistem
14 është -- kjo ndihmë duhet të jetë në njëfarë mënyre si një hartë
15 rruge, si një udhërrëfyes për të ndihmuar Mbrojtjen për t'i marrë
16 ato materiale, për t'i përdorur, për të kuptuar çështjen, dhe në
17 fund, sigurisht për t'i trajtuar dhe për të vendosur përparësitë e
18 saj lidhur me hetimet që do të zhvillojë.

19 Në këtë rast ka 124 dëshmitarë që janë bërë të njohur shumica
20 e tyre, siç e dini, me pseudonime. Nuk na është dhënë ndonjë
21 përmbledhje. Nuk kemi as edhe pesë rreshta lidhur me çfarë do të --
22 për çfarë do të diskutojnë këta dëshmitarë. Asnjë dëshmitar nuk
23 është bërë i njohur, i ditur, bashkë me provat shoqëruese. Sepse
24 kur ka një dëshmitar duhet të ketë edhe prova të cilat lidhen me
25 atë dëshmitar, dhe jo të na lihet ne që ta lidhim dëshmitarin me

1 dokumente të caktuara që lidhen me të.

2 Mungojnë hollësitë në lidhje me materialin që -- në lidhje me
3 tabelat mungojnë hollësinë. Dhe ZPS-ja vazhdon të veprojë kështu,
4 se kështu e thonë dhe në argumentet e tyre. Mungojnë metadatat
5 lidhur me "Legal Work" //siç u përkthye// tabelat në bazë të "Legal
6 Flow" //siç u përkthye//.

7 Pra, janë disa pika të cilat po t'i marrim së bashku krijojnë
8 problem.

9 Për sa i takon hollësive, do të doja t'ia kaloja fjalën
10 Sophie-së, Sophie Menegon, me lejen tuaj.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sigurisht.

12 Znj. Menegon, keni fjalën.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
14 nderuar Gjykatës.

15 Lidhur me identifikimin e dëshmitarëve të Prokurorisë vërtet
16 kemi vështirësi, sepse deri tani kemi identifikuar 124 dëshmitarë
17 që kanë marrë një numër. Por Prokuroria, me sa kuptoj unë, nuk ka
18 ndërmend t'i përdorë të gjithë për gjyq. Por neve na është dhënë --
19 na janë dhënë shumë materiale nga dëshmitë e tyre, nga deklaratat e
20 tyre, transkripti i intervistave, dhe janë më shumë se 200 prova të
21 tilla si prova inkriminuese.

22 Prandaj dëshirojmë që të na jepet një listë e dëshmitarëve të
23 mundshëm të cilët mund të thirren nga Prokuroria për të dëshmuar,
24 me qëllim që ne të fokusojmë hetimet tona. Sepse kështu siç janë
25 punët, na duhet të hetojmë rreth 300 dëshmitarë, që është shumë dhe

1 kërkon shumë përgatitje.

2 Përpara, në gjykata të tjera, p.sh., në Gjykatën Penale
3 Ndërkombëtare Prokuroria nxjerr materiale që lidhen me një
4 dëshmitar, i jep dëshmitarëve një numër dhe i përcakton një
5 kategori inkriminuese apo fajësuese, dhe jo kjo gjë të bëhet vetëm
6 disa muaj përpara fillimit të gjykit. Ne e kërkojmë sqarimin
7 tani.

8 Lidhur me identifikimin e materiale të lidhura me secilin
9 dëshmitar e kemi vështirë, sepse tani i vetmi informacion që na
10 jepet është në përshkrimin e dokumenteve në Workflow. Prokuroria
11 jep vetëm pseudonimin e dëshmitarit. Kur ne lexojmë pastaj
12 deklaratën apo transkriptin e intervistës shohim se janë treguar
13 disa dokumente për Prokurorinë, dhe këto dokumente nuk na jepen ne
14 njëkohësisht me numrin e dëshmitarit. Në rastin e disa e
15 dëshmitarëve nuk jepet referenca për dokumentin e dhënë
16 Prokurorisë, apo ka një referencë të paplotë apo një referencë, dhe
17 kur ne kërkojmë në Workflow nuk e gjejmë dokumentin dhe ky dokument
18 nuk na është bërë i njohur.

19 Pra, ne kërkojmë që Prokuroria sistematikisht me çdo
20 transkript, deklaratë të një dëshmitari apo të akuzuari, të japë të
21 gjitha dokumentet e dhëna nga dëshmitari, të komentuar nga
22 dëshmitari, dhe të vendosë një lidhje me një dëshmitar të tillë.
23 Për shembull, në Legal Workflow apo në një kategori tjetër, një
24 metadata tjetër të lidhur me dëshmitarin. Sepse ne kështu siç është
25 puna, ne harxhojmë shumë kohë për të identifikuar materialet e

1 lidhura me dëshmitarët. Dhe është një gjë që Prokuroria mund ta
2 bëjë shumë kollaj. Dhe thjesht duhet të jetë më efikase për të qenë
3 të gatshëm në një fazë më të mëhershme.

4 Sepse në gjykata të tjetra ne e kemi pasur të lehtë të gjejmë
5 lidhjen midis dokumenteve dhe dëshmitarit. Në raste të tjera, pra,
6 kemi pasur një zinxhir të plotë nga dëshmitari deri te materialet,
7 kurse kështu siç janë punët këtu, neve nuk i kemi këto. Duhet të
8 japë, pra, siç thashë, dokumentin që lidhet me dëshmitarin me
9 qëllim që ne të kemi mundësi të identifikojmë relevancën e
10 materialeve.

11 Prandaj duam ta theksojmë sot dhe - ne e kuptojmë dhe
12 qëndrimin e Prokurorisë - ne kërkojmë një lidhje më të qartë, pra,
13 të dokumentit me dëshmitarin. Për shembull, ka një dëshmitar dhe
14 unë -- nuk është konfidenciale, është një dëshmitar i cili solli
15 p.sh., një certifikatë të anëtarëve të familjes me vete. Por në
16 Legal Workflow p.sh., kjo certifikatë, për të cilën po flas, nuk
17 është e lidhur me dëshmitarin. Por ne mundëm ta gjejmë lidhjen
18 vetëm në bazë të mbiemrit të dëshmitarit. Pra, nëse në kronologjinë
19 e mbajtjes në ruajtje të materialeve jepen këto të dhëna neve na
20 lehtësohet puna, sepse në këtë rast ne e dimë p.sh., që dokumenti
21 është dhënë nga dëshmitari.

22 Pra, është një lloj çështjeje me të cilën ne përballohem, dhe
23 na e ngadalëson punën dhe na pengon të fokusohemi te hetimet tona.
24 Faleminderit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Menegon.

1 Përpara sesa t'ia jap fjalën Prokurorisë të përgjigjet,
2 dëshiroj njëherë të flasim të gjithë përfaqësuesit e Mbrojtjes dhe
3 pastaj Prokuroria të ketë mundësi të përgjigjet.

4 Z. Emmerson, keni fjalën.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë pajtohem
6 plotësisht me tablonë e përgjithshme të vështirësive që paraqiti z.
7 Hooper, dhe analizën më të hollësishme të problemeve më specifike
8 që u dhanë si shembull nga zonjusha Menegon.

9 Situata në përgjithësi është kështu: Mënyra sesi po bëhet
10 nxjerrja e materialeve është mënyra më e padobishme e mundshme për
11 Mbrojtjen, për t'i lejuar asaj që të bëjë hetimet e veta. Është në
12 mënyrë të -- është bërë pa diskriminim, është e paorganizuar, është
13 një sasi kaotike materialesh të cilat duhet të shihen në imtësi dhe
14 të analizohen në mënyrë që të rindërtojmë se çfarë po thotë
15 Prokuroria dhe pastaj të fillojmë hetimet tona.

16 Dhe unë nuk dua të ketë asnjë lloj keqkuptimi për këtë pengesë
17 të jashtëzakonshme që na është krijuar nga mënyra sesi po e bën
18 punën Prokuroria.

19 Ka dy mënyra sesi mund ta lexojmë këtë. E para është që ata
20 janë krejtësisht jokompetentë; dhe kjo nuk besoj se është e
21 vërtetë. Dhe e dyta është që kjo është e qëllimshme, dhe këtë mund
22 ta shikojmë edhe te parashtrimi që bëri Prokuroria sot në mëngjes
23 se ato lidhjet me dëshmitarët nuk duhet të bëhen.

24 Ne e kuptojmë që duhet të mbrohen dëshmitarët, po ajo që nuk e
25 kuptojmë është se pse na duhet ne ta ndërtojmë çështjen e

1 Prokurorisë nga një shumësi materiale, të cilat ata nuk kanë bërë
2 asnjë lloj dallimi kur na i kanë dhënë dhe ta bëjmë ne shqyrtimin e
3 tyre që të fillojmë hetimet tona. Dhe përsëri nuk duhet të ketë
4 asnjë lloj keqkuptimi se këtu kjo na pengon mjaft në punën tonë,
5 dhe do të pengojë dhe kohën kur do të fillojë gjyqi.

6 Unë, sigurisht, i nderuar Gjykatës, e di që ju keni marrë
7 materiale të organizuara me disa shënime nga Prokuroria që lidhin
8 provat që ju janë paraqitur ju në një mënyrë koherente, të cilat do
9 t'ju ndihmojnë në marrjen e vendimit për konfirmimin -- ju kanë
10 ndihmuar në marrjen e vendimit për konfirmimin e aktakuzës. Kurse
11 ne si Mbrojtje nuk kemi pasur asnjë dosje paraprake të Prokurorisë.
12 Shumë herë Prokuroria ka refuzuar të na e japë dosjen paraprake dhe
13 do të na e japë vetëm në momentin e fundit para gjykimit,
14 megjithëse ajo mund të jetë gati që në fillim, nuk e di, në maj apo
15 në qershor të këtij viti.

16 Pra, Prokuroria e di se për çfarë bën fjalë dosja e vetë sepse
17 ata jua kanë dhënë ju këtë dosje. Ajo që po bëjnë ata me ne është
18 që i kanë shkarkuar të gjitha materialet në bazën e të dhënave, i
19 kanë redaktuar informacionet e rëndësishme dhe i kanë varrosur
20 provat relevante në një mal provash dhe materiale të tjera që
21 mund të jenë krejtësisht irelevante.

22 Ne si Mbrojtje nuk po ankohemi kot. Fakti është, që ta bëjë
23 Mbrojtja punën që duhet të bëjë duhet të ketë aktakuzën, dhe ne
24 duhet të shikojmë materiale të tëra për të kuptuar se çfarë po
25 pretendon Prokuroria aty. Dhe ka rreth 34 vendngjarje krimesh.

1 Secila prej tyre ka kronologjinë e vetë. Asnjëra prej tyre nuk
2 është analizuar siç duhet nga Prokuroria. Ato janë thjesht futur në
3 një tufë materialesh të tërë, dhe Mbrojtja nuk është në gjendje të
4 përgatitet ashtu siç duhet dhe të përgatisë dosjen e vetë.

5 Ne kemi krijuar një ekip hetues i cili është i gatshëm të
6 fillojë punën që nga fillimi i janarit. Dhe ne presim që do të na
7 duhet nga marsi apo mesi i prillit, në mënyrë që të rindërtojmë nga
8 materiali që na kanë hedhur për të bërë një lloj analize të
9 çështjes së Prokurorisë. Pra, ne na duhet që t'u themi hetuesve se
10 çfarë pune të bëjnë.

11 Dhe nuk e di nëse Prokuroria nuk e di si ta bëjë punën dhe
12 d.m.th., nuk i jep mundësi Mbrojtjes që ta bëjë punën ashtu siç
13 duhet. Nuk e di nëse ajo që po ndodh këtu është që Prokuroria është
14 kaq e fokusuar te nocioni që katër të akuzuarit duhet të dënohen
15 patjetër, dhe të gjithë dëshmitarët e Prokurorisë duhet të
16 redaktohen, ato, deklaratat e tyre dhe tejet të redaktohen. Nuk e
17 di nëse është kjo, është ajo që e drejton punën e z. Smith në këtë
18 çështje.

19 Por duhet të them që është personi që është -- si personi që
20 është përgjegjës për strategjinë e Prokurorisë, ai duhet t'i
21 përgjigjet këtyre pyetjeve. Dhe ajo që është e jashtëzakonshme dhe
22 sipas përvojës time në gjykatat ndërkombëtare, kjo është një mënyrë
23 shumë kaotike dhe e paprecedentë e paraqitjes së materialit.

24 Z. Hooper përshkroi që nuk kemi një udhërrëfyes. Kjo është një
25 mënyrë shumë e lehtë për ta thënë këtë. Një shumësi materialesh na

1 është shkarkuar neve dhe ne po përpigemi të kuptojmë se kush është
2 relevante dhe cili nga materialet nuk është relevant.

3 Ju, i nderuar Gjykatës, e kuptoni nga analiza e provave që
4 pretendimet e tij kundër klientit tim për shembull, Kadri Veselit,
5 është shumë e dobët. Ajo bazohet në prova që nuk -- pothuajse nuk
6 ekzistojnë. Ai nuk është përmendur në asnjë nga provat se ka kryer
7 ndonjë veprimtari kriminale.

8 Kjo është një çështje që është ngritur me përpjekjen për të
9 ngritur një ndërmarrje kriminale të përbashkët duke i vendosur të
10 gjithë personat në një vend. Kjo është një shembull paradigmë i një
11 situate ku duhet të kemi një kuptim të qartë sesi po përpigjet
12 Prokuroria të ndërtojë çështjen e vetë. Sepse në qoftë se nuk kemi
13 nga Prokuroria se çfarë thonë ata për secilin të akuzuar, atëherë
14 s'ka kuptim. Janë 34 vendngjarje të ndryshme të krimeve që
15 pretendohen se janë kryer, dhe në asnjë prej tyre nuk thuhet që ai
16 ka qenë i pranishëm, apo që ka kryer ndonjë prej atyre krimeve.

17 Unë mendoj që kjo nuk është një çështje e menaxhimit të
18 përditshëm, apo lidhjes së dëshmitarëve me numra apo me provat
19 materiale, apo me krosreferencat e dëshmitarëve. Këto janë të
20 gjitha detaje apo imtësi. Problemi i përgjithshëm i Prokurorisë
21 është -- më mirë të na thonë ata, cili është problemi? Sepse derisa
22 të na e thonë ata se cili është problemi, ne do të mbetemi kështu
23 në errësirë.

24 Ne duhet që ta fillojmë procesin nga e para. Të marrim të
25 gjithë këtë volum materialesh, t'i lexojmë të gjitha ato, çdo fjalë

1 edhe njëherë nga e para dhe t'i analizojmë ato. Unë sigurisht e kam
2 bërë këtë, ne e kemi bërë si ekip për z. Veseli, dhe prandaj them
3 që aty s'ka asnjë fije provë kundër tij.

4 Por përveç kësaj, duhet lexuar çdo material, çdo fjalë, për të
5 kuptuar se çfarë po përpiqet të thotë Prokuroria me materialet që
6 na ka dhënë. Dhe duhet të marrësh me mend se çfarë lloj çështjeje
7 po ngre Prokuroria dhe sesi nga kjo shumësi materialesh duan të
8 sigurojnë një dënim për këta të akuzuar.

9 Sigurisht, këto janë pengesa shumë të rëndësishme që duhet t'i
10 kapërcejmë ne. Nuk e di, sigurisht ne si Mbrojtje do të
11 ndihmoheshim shumë në qoftë se Prokuroria do të na jepte këto
12 materiale dhe do të na thoshte një datë se kur do të na i japë ato.

13 Pra, çështja që dua të kuptoj unë është një pyetje që ia bëj
14 direkt z. Smith, dhe them që ai duhet të na thotë qartësisht se
15 çfarë do të bëjë; të na shpjegojë se çfarë do të arrijë me këtë
16 shumësi të madhe materialesh; dhe të na shpjegojë në mënyrë të
17 saktë se çfarë çështje ka ngritur dhe si pretendon ta provojë
18 fajësinë e këtyre të akuzuarve.

19 Mbrojtja duhet të bëjë gjithë këtë përzgjedhje, të ndajë
20 materialet relevante nga ato jorelevante, dhe Prokuroria nuk i ka
21 dhënë asnjë lloj ndihme, asnjë lloj organizimi. Dhe në qoftë se ne
22 pastaj kemi arritur në konkluzionin e gabuar që do të na dalë kur
23 të marrim dosjen paraprake të Prokurorisë, që ajo që kemi menduar
24 ne është krejt ndryshe nga ajo që ka Prokuroria, duhet të fillojmë
25 punën nga e para.

1 Pra, kemi detyrime dhe kemi përgjegjësinë etike të sigurojmë
2 që të mos marrim pjesë në procedura të cilat do të rrëshqasin në
3 mohim të drejtësisë. Në qoftë se kjo çështje do të vazhdojë në
4 mënyrën sesi po bëhet deri tani dhe Prokuroria do të vazhdojë të
5 sugjerojë që data e fillimit të gjyqit do të jetë shtatori, ne do
6 të jemi në një vështirësi të madhe. Ne do të vendosemi në një
7 pozitë që nuk është e përshtatshme nga ana etike për ne si
8 profesionistë.

9 Dhe ka ardhur koha, i nderuar Gjykatës, që ju ta merrni në
10 dorë situatën dhe ta shtroni Prokurorinë, si të thuash, sepse ne po
11 shohim që Prokuroria po e bën punën e Mbrojtjes shumë të vështirë.
12 Dhe i vetmi përfundim që mund të nxjerr unë nga kjo është që
13 Prokuroria ende nuk e ka kuptuar as vetë se çfarë çështje po ngre
14 dhe prandaj i ruan deri në -- dorëzimin e dokumenteve dhe dorëzimin
15 e dosjen deri në minutën e fundit.

16 Pra, e ftoj z. Smith që të ngrihet tani dhe të shpjegojë sesi
17 pret ai që Mbrojtja të kryejë mbrojtjen apo të fillojë hetime
18 efektive, dhe pse nuk ka thënë qartë se cilat prej provave të tij
19 janë ato të cilat ata do të mbështeten dhe cilat jo.

20 Kaq kisha si parashtrim.

21 Për sa i përket se kur do të fillojnë dhe kur do të mbarojnë
22 hetimet e Mbrojtjes, përgjigjja ime është: Sa të duash. Sa kohë
23 kemi në dorë, sepse ne duhet ta përgatitim çështjen tonë ashtu siç
24 duhet, por edhe Prokuroria duhet të na ndihmojë që ne ta hetojmë
25 çështjen tonë ashtu siç duhet.

1 Ne kemi dëgjuar nga Prokuroria shumë herë që thotë: "Oh, ne
2 jemi shumë të shqetësuar dhe duam të sigurojmë drejtësinë e këtyre
3 procedurave." Por ne nuk e besojmë këtë, sepse çdo metodologji e
4 përdorur nga Prokuroria është njëlloj taktike që në juridiksionin
5 nga vij unë do të çonte në ndëshkim nga Gjykata. Gjykata vetë në
6 këtë fazë duhet të ndërhyjë dhe ta pyesë Prokurorinë se pse po e
7 pengon apo pse po ia bën kaq të vështirë Mbrojtjes përgatitjen e
8 saj.

9 Unë këtë e them për procesverbal. Dua ta bëj të qartë që
10 Prokuroria e përdori këtë mundësi të Konferencës për Ecurinë e
11 Çështjes, që të shkojë përtej rendit të ditës që keni dhënë ju, dhe
12 të japë përsëri atë datë qesharake për fillimin e gjykimit.

13 Pse e bëjnë këtë? Mbrojtja thotë që ajo është e pamundur. Unë
14 ia lë të tjerëve që të nxjerrin përfundimin pse kanë vendosur ata
15 që të deklarohen për një pikë që nuk është në rendin e ditës. Dhe
16 ju vetë keni thënë në vendimin tuaj që dhënia, ose mendimet për
17 fillimin e gjykimit është ende e parakohshme që të jepen. Sepse
18 data e gjykimit do të jepet pasi të jenë marrë parasysh nevojat e
19 Mbrojtjes. Pra, unë e them që do të jetë ende shumë herët për të
20 caktuar një datë gjyqi derisa Prokuroria të japë mendimin e vetë
21 dhe të na japë informacionet e veta.

22 GYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, e thamë që është
23 shumë herët për të ngritur këtë çështjen e datës së gjykimit.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk po e ngre
25 unë këtë. E ngriti Prokuroria dhe kjo nuk ishte në rendin e ditës.

1 Unë them që Prokuroria nuk po drejtohet mbi bazat bazë të
2 punës së ndjekjes penale, që duhet të jenë të drejtë dhe objektivë
3 në lidhje me Mbrojtjen, që ata, të akuzuarit duhet t'i kuptojnë se
4 çfarë akuzash ka kundër tyre dhe të kenë mundësi të hetojnë dhe të
5 përgatisin mbrojtjen e tyre.

6 Është shumë e qartë, dhe unë si gjykatës që kam qenë në
7 gjykime të ndryshme për shumë vite, unë them që Prokuroria këtu do
8 që të shmangë, ose ta nxjerrë nga rruga e duhur Mbrojtjen dhe që
9 Mbrojtja të mos jetë e përgatitur ashtu siç duhet.

10 Kaq kisha për të thënë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

12 Tani z. Young, e keni fjalën.

13 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar, z.

14 Gjykatës, në kuadrin e asaj çfarë u tha nga kolegët e mi, në fakt
15 nuk kam asgjë tjetër për të shtuar pasi do të përsërisja ato çfarë
16 thanë kolegët e mi të nderuar.

17 I nderuar Gjykatës, do të doja të thosha që jemi tërësisht --
18 i qëndrojmë parashtrimeve të shkruara sa i takon nxjerrjes së
19 dokumenteve nga ZPS-ja.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Znj. Alagendra, fjala për juve.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk e di në
23 qoftë se mund t'i drejtohem kolegut tim, z. Ellis për të trajtuar
24 çështjen e nxjerrjes së dokumenteve.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Patjetër.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar z.
2 Gjykatës, çështjet të cilat janë identifikuar sot nga skuadrat e
3 tjera të Mbrojtjes janë çështje të cilat janë të përbashkëta për të
4 gjitha ekipet e Mbrojtjes së të akuzuarve si pjesë e kësaj
5 çështjeje që po trajtohet sot. Kështu që nuk do të doja që të
6 përsërisja edhe njëherë përmbajtjen e parashtimeve, por do të doja
7 të thosha që jam plotësisht dakord me shqetësimet e ngritura nga
8 kolegët e mi, nga Mbrojtja e të akuzuarve të tjerë në këtë çështje.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

10 Tani më lejoni t'ia jap fjalën Prokurorisë.

11 Znj. Prokurore, fjala për ju.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

13 Mbrojtja e z. Veseli foli për elemente shumë të përgjithshme
14 sa i takon volumit kaotik të materialeve që është vënë në
15 dispozicion pa një udhëzim. Në fakt, kjo është e pasaktë.

16 Është fakt që Mbrojtja e z. Veseli, parashtimet e Mbrojtjes
17 së z. Veseli nuk janë gjë tjetër veçse një çështje retorike.
18 Ndërkohë më duhet të them që kjo është diçka të cilën ne e kemi
19 dëgjuar nga Mbrojtja e z. Veseli në shumë konferenca të procesit
20 gjyqësor dhe nuk duhet të tolerohet më nga kjo Gjykatë.

21 Mbrojtja në fakt është pajisur me një udhëzim specifik lidhur
22 me materialin e nxjerrë në formatin e rregullës 86(3)(b), që është
23 ekzaktësisht udhëzimi që ka marrë Gjykatësi i Procedurës Paraprake
24 kur ka bërë vlerësimin e të njëjtin material.

25 Për më tepër, materialet janë nxjerrë në përputhje me rregulla

1 specifike të cilat dëshmojnë në mënyrë të qartë në qoftë se
2 materiali -- mbi materialin është mbështetur ZPS-ja apo jo. Do të
3 jemi të lumtur që t'i kthehemi komenteve për sa i takon gjendjes së
4 përgatitjeve dhe hetimeve në momentin kur të vijë pika në agjendën
5 e ditës së sotme.

6 Sa i takon parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Thaçi, besoj se
7 këto pika i ngrita edhe në komentet e mia fillestare. Në pjesën më
8 të madhe të rasteve, më duhet të them, që deklaratat të cilat janë
9 nxjerrë si materiale për Mbrojtjen, janë materiale të cilat ne
10 synojmë që t'i përdorim gjatë procesit gjyqësor.

11 Më tej, në kohën e duhur të gjitha provat materiale do të
12 përcaktohen me referenca në intervista.

13 Sa i takon Mbrojtjes së z. Thaçi lidhur me përmbledhjen e
14 secilit dëshmitar, besoj që një raport i tillë i përmbledhjes do të
15 nxirret në përputhje me rregullën 95(4) në kohën e duhur dhe në
16 përputhje me kohën e përcaktuar në rregullore.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

18 Ndonjë nga ekipet e Mbrojtjes, a dëshironi që t'i përgjigjeni
19 asaj çfarë tha znj. Prokurore.

20 Z. Hooper, fjala për ju.

21 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk e di në më
22 dëgjoni?

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, ju dëgjojmë. Ju lutem,
24 vijoni.

25 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] E dëgjoj znj.

1 Lawson. Ajo sapo tha që i ka trajtuar shqetësimet tona që në fillim
2 të seancës. Në fakt nuk i ka trajtuar. Pyetja dhe çështja që ngremë
3 ne është shumë e drejtpërdrejt dhe ne kërkojmë detaje të materialit
4 i cili na është nxjerrë ne si palë mbrojtëse. Dhe po kërkojmë
5 gjithashtu që të kihet një lidhje e qartë ndërmjet deklaratave të
6 dëshmitarëve dhe provave materiale që kanë të bëjnë me dëshmitarët
7 përkatës. Pra, a është e mundur që të kemi lidhjen ndërmjet
8 dëshmitarëve potencialë gjatë intervistimit që ju keni bërë me
9 provat përkatëse për këta dëshmitarë?

10 Mendoj që ato çfarë kemi dëgjuar deri tani nga z. Lawson, nuk
11 është se ka trajtuar çështje themelore të cilat neve i ngritëm edhe
12 sot. Dhe mendoj që ka ardhur pika ku, i nderuar Gjykatës, që do të
13 duhet që të ndërhyri për të ndihmuar kryesisht Prokurorinë që të
14 krijojë dhe të ketë një qasje sistematike, një qasje e cila është
15 në të vërtetë ndihmëse për ne. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

17 Z. Emerson.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do të doja të
19 jepja një përgjigje shumë të shkurtër në raport me akuzën që mu bë
20 mua, që unë kam bërë komente të papërshtatshme dhe që nuk janë të
21 lejuara.

22 Dua që të sqaroj diçka që të mos ketë keqkuptime, parashtimi
23 im - dhe në qoftë se doni mund ta quani edhe si sulm frontal -
24 parashtimi im nuk është se i drejtohet një personi individual
25 brenda Prokurorisë, me përjashtim të faktit që z. Black (siç u tha)

1 është Prokurori i ZPS-së, dhe si rezultat është personi përgjegjës
2 për të siguruar që Prokuroria ta bëjë punën e vetë në mënyrë që
3 është konsistente, jo vetëm me rregulloren por edhe me nevojën për
4 të siguruar drejtësi për Mbrojtjen dhe për të siguruar procesin e
5 rregullt ligjor që është një ndër parimet themelore të gjykimit.

6 Dhe, siç e thashë, nuk është një sulm personal kundër njërit
7 apo tjetrit. Sigurisht që unë përmenda z. Smith, që ai duhet të
8 ngrihet dhe të bëjë mbrojtjen e duhur. Dhe sigurisht unë ju
9 drejtohem ju, z. Gjykatës, që të merrni veprimet e nevojshme, sepse
10 mënyra sesi funksionon sistemi është i tillë që roli gjyqësor është
11 tërësisht i pavarur dhe ju duhet që të hiqni pengesat nga të dyja
12 anët në mënyrë që të siguronit që drejtësia të vihet në vend.

13 Dhe siç është situata aktualisht, duket sikur Prokuroria ka
14 një politikë që këtë çështje ta bëjë sa më të vështirë për
15 Mbrojtjen që të hetohet prej nesh në kohën e propozuar. Dhe, siç e
16 tha dhe z. Hooper, neve do i kërkonim gjyqësorit të pavarur të
17 ndërhyjnë dhe t'i sjellin në rrugën e duhur Prokurorinë, dhe sepse
18 nuk duhet që të lejohet nga roli gjyqësor që të shkohet nga
19 Prokuroria në një drejtim të paduhur. Dhe për këtë arsye më duhet
20 të them që asnjë nga avokatët e Dhomës së Avokatëve Britanikë nuk
21 mund të marrë pjesë në një proces gjyqësor që nuk është i drejtë
22 për të dyja palët. Dhe për këtë arsye unë mendoj që duhet të hiqet
23 një vijë.

24 Ne nuk po diskutojmë elementet e kohës sot, dhe kjo, çfarë unë
25 thashë, nuk është se duhet që të lexohet si një sulm personal

1 kundër ndonjë personi, por është një "sulm" i Mbrojtjes në
2 përgjithësi që ka të bëjë me mënyrën e organizimit të procedurës.
3 Dhe z. Black, siç e thashë edhe më përpara, ai është në krye të
4 Prokurorisë ndërkohë që nuk është se kemi dëgjuar asnjëherë prej
5 tij të shprehet lidhur me këtë çështje.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

7 Nuk e di në qoftë se z. Young apo znj. Alagendra, në qoftë se
8 keni për të thënë ndonjë gjë?

9 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar z.
10 Gjykatës, dua të them vetëm kaq, që në parashtrimet që kemi
11 dorëzuar ne kemi thënë që kemi bashkëpunuar me palë të tjera, në
12 veçanti sa i takon rregullës 109(c) dhe çështjes së kategorizimit.
13 I nderuar z. Gjykatës, shpresoj që ka ardhur koha që ju të bëni një
14 vendim -- të merrni një vendim të rëndësishëm që është në përfitim
15 të palëve.

16 Thjesht doja ta nënvizoja rëndësinë e kësaj çështjeje. Pra, që
17 ju të bëni një vendim sa i takon kategorizimit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pa diskutim. Pa diskutim z.
19 Young. Kjo është një çështje e cila është e parashikuar në agjendën
20 e ditës së sotme. Do t'i kthehemi asaj pas disa minutash. Jam
21 plotësisht dakord me ju që mbase kjo është një çështje e cila
22 lidhet shumë me atë çfarë është diskutuar deri tani, dhe sigurisht
23 që është koha që të sqarohet çështja për të gjithë.

24 Nuk e di në qoftë se ka ndonjë çështje tjetër që të sqarohet
25 lidhur me këtë element. Nuk e di Prokuroria nëse ka për të thënë

1 diçka? Ju lutem, sa më shpejt për të gjitha palët.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do t'i bie shumë shkurt.

3 Dua të them që vijat që duhet të hiqen duhet të bëhen
4 mbështetur në informacione të sakta. Pra, sa i takon parashtrimeve
5 të Mbrojtjes së z. Veseli, nuk është e drejtë që ato janë lënë pa
6 një udhëzim për materialin.

7 Ndërkohë që sa i takon emrit të Prokurorit të Përgjithshëm, do
8 të doja t'i thosha Mbrojtjes që emri i tij është Jack Smith dhe nuk
9 është Black.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

11 Tani kalojmë te pika e dytë e agjendës së ditës së sotme. Ka
12 të bëjë me përkthimin e materialit në mbështetje të rregullës
13 86(3) (b).

14 Jam informuar që procesi i përkthimit është në vijim e sipër.
15 Do të doja të falënderoja Zyrën e Administratores për punën e bërë.

16 Ndërkohë që tani do të doja t'i kërkoja Administratores të më
17 thoshte se kur parashikohet që të përfundojë përkthimi dhe në qoftë
18 se ekziston mundësia për përshpejtimin e këtij procesi. Do të doja
19 që t'i kërkoja Zyrës së Administratorit që të informojë Gjykatën në
20 qoftë se ekziston mundësia që një pjesë e vogël e këtij materiali
21 do të mund të ishte gati, siç është kërkuar prej disa prej ekipeve
22 të Mbrojtjes, përpara datës 20 prill të vitit 2021.

23 Z. Roche, fjala për ju.

24 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Gjykatës.

25 Siç e keni theksuar edhe ju z. Gjykatës, pra, dosja që është

1 dorëzuar më datë 8 shkurt, me numër reference 192.

2 Pra, është sa i takon përkthimeve -- përkthimit të këtij
3 materiali që parashikohet mbi bazën e rregullës 86(3)(b), ne i kemi
4 dhënë përparësi përkthimit. Kemi përfshirë rreth gjashtë përkthyes,
5 ndërkohë që bëhet fjalë për një dokument i cili është goxha
6 voluminoz, është rreth 160 //siç u përkthye//faqe. Pra, siç thashë,
7 ne i kemi dhënë përparësi të madhe dhe parashikohet që i gjithë ky
8 volum pune të mund të përkthehet dhe të rishikohet deri në fund të
9 majit të këtij viti.

10 Dhe si përgjigje e pyetjes tuaj, neve kemi mundësi që t'iu
11 japim pjesë të dokumentit në momentin kur të mund të jetë e
12 gatshme. Dhe parashikojmë që 150 faqe t'i kemi gati deri më datë
13 20. Ndërkohë që, siç thashë më përpara, parashikohet që i gjithë
14 dokumenti të mund të përkthehet dhe të rishikohet deri në maj të
15 vitit 2021. Dhe mbase, do të them që ndoshta mund të ketë arsye për
16 ta përshpejtuar pak këtë proces, megjithatë mendoj që ajo çfarë
17 është shumë e rëndësishme është pjesa e cilësisë së përkthimit dhe
18 të redaktimit të këtij materiali.

19 Do të doja të thosha në përmbyllje, që materiali do të jetë i
20 gatshëm deri në fund të majit, i gjithi i përkthyer dhe i
21 redaktuar, ndërkohë që rreth 150 faqe do të jenë të disponueshme jo
22 më vonë se data 20 prill.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roche.

24 Nuk di në qoftë se ndonjëri nga ekipet e Mbrojtjes dëshiron të
25 thotë diçka lidhur me këtë çështje?

1 Z. Young, fjala për ju.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar z.
3 Gjykatës, faleminderit.

4 Thjesht doja të thosha që e vlerësojmë shumë shpjegimin e bërë
5 nga Zyra e Administratorit lidhur me përkthimin. Pra, në një
6 çështje të tillë, pra, dokumentet në gjuhën shqipe janë shumë të
7 rëndësishme, kështu që është absolutisht kritike, e rëndësishme që
8 dokumenti t'i vihet në dispozicion të akuzuarve në gjuhën e tyre në
9 mënyrë që ata të kenë kohën e mjaftueshme për të lexuar materialin
10 në tërësi.

11 Ndërkohë, i nderuar z. Gjykatës, Zyra e Administratores sapo
12 tha që përkthimit i është dhënë përparësi e madhe, dhe tha që
13 dokumenti do të jetë i gatshëm i tëri nga fundi i majit. Siç mund
14 ta kuptoni, ky është një ndër dokumentet më të rëndësishëm që
15 Prokuroria ka ofruar për këtë çështje. Pra, ky është vetëm një
16 dokument në fakt, ndërkohë që ka mijëra e mijëra dokumente të
17 tjerë.

18 Ndërkohë që konstatohet se mund të thuhet me saktësi që një
19 dokument i vetëm i tillë me përparësi nuk mund të jetë i gatshëm
20 për t'iu vënë në dispozicion të akuzuarve deri në fund të majit, në
21 mënyrë që të akuzuarit pra, të kenë mundësi që të lexojnë në gjuhën
22 e tyre, kjo në vetvete në fakt është goxha shqetësuese.

23 Kjo në vetvete demonstroi në mënyrë shumë të qartë problemin
24 që kemi sa i takon elementit kohë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

1 Z. Ellis, fjala është për ju.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit i
3 nderuar Gjykatës.

4 Kjo është një çështje shqetësuese, veçanërisht për z.
5 Krasniqi, sepse z. Krasniqi nuk flet as nuk kupton anglisht. Kështu
6 që nuk kemi të bëjmë me një çështje procedurale, por z. Krasniqi
7 vërtet ka nevojë për këtë dokument në versionin e vetë në gjuhën
8 shqipe, në mënyrë që të mund të fillojë të lexojë dhe të marrë
9 udhëzime për një akuzë -- për aktpadinë që është ngritur për të.

10 Kështu që në këtë pikë, pra, mendoj që kjo është diçka e cila
11 mund të bëhet një shqetësim edhe më i madh dhe më i shtrirë, sepse
12 kemi rreth 298 //siç u përkthye// dosje, zëra për momentin dhe prej
13 tyre vetëm 65 janë përkthyer në gjuhën shqipe. Dokumentet të cilat
14 janë përkthyer, janë dokumente të cilat përgjithësisht janë
15 njoftime të shkurta apo dokumente që kanë të bëjnë me konferenca
16 për gjendjen gjyqësore, ndërkohë që ka vendime të cilat nuk janë
17 përkthyer në shqip, që janë të rëndësishme, si p.sh., vendimet për
18 lirim të përkohshëm apo për konfirmimin e aktakuzës.

19 D.m.th., janë dokumente shumë të rëndësishme të cilat duhet të
20 ishin në shqip. Dhe prandaj është e rëndësishme që dokumenti, i
21 cili i referohet rregullës 86(3), të mund të përkthehet sa më
22 shpejt të jetë e mundur.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

24 Nuk shoh që ka ndonjë person tjetër që do të marrë fjalën.

25 Dua që të përmend dy gjëra: Së pari, do të doja t'i kërkoja

1 Zyrës së Administratorit në qoftë se dokumenti mund të përkthehet
2 më përpara sesa planifikohet, ose të paktën një segment, një pjesë
3 e tij, sepse do të vlerësohej shumë në qoftë se ky dokument do të
4 mund t'i jepej sa më shpejt të ishte e mundur ekipeve të Mbrojtjes.
5 Dhe do të doja që të përmendja për Mbrojtjen një listë dokumentesh
6 prioritare. D.m.th., një qoftë se ka dosje ose informacione,
7 dokumente të cilat të jenë më të rëndësishme se të tjerat, është
8 mirë që të mund të informohet Zyra e Administratorit në mënyrë që
9 të mund t'i jepet përparësi këtyre dokumenteve në raport me
10 ngarkesën e përgjithshme të punës së përkthimit.

11 Në qoftë se nuk do njeri tjetër të marrë fjalën për këtë pikë,
12 do të doja të kalojmë në pikën e tretë në rendin e ditës. Pra, kemi
13 të bëjmë me pikën që ka të bëjë me rregullën 108(c) //siç u
14 përkthye//, pra, me tabelat. Kështu që në këtë pikë nuk do të doja
15 që t'u kërkoja palëve që të përsërisin gjërat që kanë thënë, sepse
16 shumë gjëra u thanë sa i takon vështirësisë së Mbrojtjes edhe
17 dëgjuam gjithashtu edhe parashtimet e ZPS-së.

18 Kështu që do të doja që t'u kërkoja që të ishit të
19 përqendruar, të fokusuar te detajet e tabelave në kuadër të
20 rregullës 109(c).

21 Nga deponimet me shkrim të palëve, pra, e kuptoj që nuk ka
22 marrëveshje ndërmjet ZPS-së dhe ekipeve të Mbrojtjes. Së pari, sa i
23 takon nivelit të nënkategorizimit të materialeve të nxjerra në
24 tabelë apo çështjes së përfshirjes së nënkategorive të tjera si
25 p.sh., pikën përkatëse të aktpadisë, krimit bazë përkatës,

1 vendndodhjes së krimit, të akuzuarin në fjalë apo mënyrës së
2 përgjegjësisë penale që i ngarkohet të akuzuarit.

3 Pra, keqkuptimi i dytë ka të bëjë me kategorizimin në fushat e
4 metadatave që ka të bëjë me çdo zë të nxjerrë, me çdo dokument të
5 nxjerrë.

6 Pra, ndërkohë kategoria e tretë ka të bëjë me parashikimet e
7 rregullës 109(c), pra, me materialet shfajësuese.

8 Mosmarrëveshja e katërt ka të bëjë me shpeshtësinë në të cilën
9 ofrohen tabela të tilla. P.sh., për çdo dosje të nxjerrjes së
10 materialeve apo duhet të bëhet pas dosjeve të procesit paraprak.

11 Do të doja që të ftoja ZPS-në që të jepte parashtrimet e veta
12 sa i takon ndikimit të propozimeve të Mbrojtjes mbi kalendarin e
13 nxjerrjes së dokumenteve, dhe në qoftë se mendon se do të japë
14 nënkategori të tilla dhe do të japë të gjithë informacionin sipas
15 detajeve që unë i dhashë më sipër.

16 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

17 Dhe do të doja t'ju kërkoja po ashtu të gjithë palëve që të
18 jenë sa më koncize të jetë e mundur në mënyrë që të cekim vetëm --
19 të trajtojmë vetëm çështjet teknike të cilat unë i shpjegoja pak më
20 sipër. Faleminderit.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kam ndonjë
22 sasi domethënëse të deponimeve të parashtrimeve të mëparshme dhe të
23 dosjeve të shkuara mbi këtë çështje. Pra, keni të drejtë kur thoni
24 që duket sikur marrëveshje të mëtejshme, ose progresi i mëtejshëm
25 duket sikur ka pak të ngjarë të ndodhë në këtë moment.

1 Dua që të qartësoj diçka, që formati i tabelës në vetvete, në
2 parim është rënë dakord ndërmjet palëve, përfshirë këtu p.sh.,
3 pikat e aktakuzës, vendngjarjet apo krimet, mënyrat e përgjegjësisë
4 penale, të cilat do të përfshihen sipas propozimeve -- do të bëhen
5 sipas propozimeve që janë bërë në kohën e dosjes paraprake.
6 Ndërkohë, në atë kohë, Zyra e Prokurorisë nuk ka qenë në favor të
7 dhënies së sabkategorizimit për të cilin u diskutua.

8 Propozimi i ZPS-së pra, është në përputhje me kërkesat e
9 parashikuara në rregullën 109(c). Çështja që ende mbetet, apo
10 pyetja në fjalë është e pamundur për ne. Fatkeqësisht ne nuk jemi
11 në gjendje që të bëjmë nënkategorizimin në një mënyrë që është në
12 përputhje me përmbushjen, ose detyrimet dhe çështjet e tjera bazë.

13 Dua që të ngre dy çështje kryesore, dy gjëra kryesore:

14 Pra, sipas nesh, Mbrojtja e ka marrë, le të themi, dokumentin
15 ose skicën e përgjithshme që parashikohet në rregullën 86(3)(b), që
16 jep informacion të detajuar për secilën prej kategorive të
17 përmendura, përfshirë këtu edhe të ndara, ose të kategorizuara
18 sipas akuzave, sipas pikave, sipas krimeve dhe vendngjarjeve.

19 Së dyti, parashtrimi i Mbrojtjes së Selimit sa i takon
20 nënkategorizimit, që u pretendua që ky nënkategorizim nuk ishte
21 korrekt, në fakt do të doja që të ishte ky rasti. Megjithatë, do të
22 doja të thosha që përgatitja për nxjerrjen e informacionit nuk
23 fillon në datën e Paraqitjes së Parë, por fillon goxha përpara
24 kësaj. Si rezultat i këtyre përgatitjeve ne vazhdojmë që të jemi të
25 vendosur për të përmbushur afatin kohor që parashikohet në Vendimin

1 Kuadër.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

3 Z. Hooper, ju lutem.

4 Z. Hooper, mikrofonin e keni të mbyllur. Akoma e keni të
5 mbyllur. Vazhdoni kështu. Tani është në rregull.

6 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Pra, Prokuroria po
7 thoshte që nuk duan -- ne nuk duam ta bëjmë siç duan ata, po siç
8 duam ne, thonë ata. Ne mund ta bëjmë. Dhe ata mund ta bëjnë. Por
9 ata nuk duan ta bëjnë këtë gjë tani.

10 Ata kanë një sistem që po përdoret, të themi, që përpara
11 konfirmimit të aktakuzës dhe nuk duan të ndahen me këtë sistem.
12 Shpresoj që të mos ta përdorin dhe për çështje të tjera. Mustafa
13 padyshim që nuk vlen në këtë rast sepse është krejtësisht e
14 ndryshme si çështje.

15 Funkcioni themelor i nxjerrjes së materialit është që të
16 ndihmojë Mbrojtjen për të gjetur rrugën e vetë në menaxhimin, në
17 administrimin e provave.

18 Znj. Menegon, a mund të thoni juve ç'keni për të thënë për
19 këtë çështje?

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Menegon.

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

22 Nuk kam shumë për të shtuar sepse ne i thamë parashtrimet tona.

23 Desha vetëm të theksoj se për ne ka shumë rëndësi që të marrim një

24 tabelë të hollësishme në momentin e çdo pakete që na bëhet e

25 njohur. Sepse siç kam vënë re, ne nuk i kemi informacionet e duhura

1 të lidhim dokumentin me dëshmitarin. Prandaj në këtë rast do të na
2 ndihmonte shumë që t'i kishim.

3 Prokuroria thotë që nuk është e nevojshme ta kemi tani këtë
4 tabelë. Po bëhet fjalë për 600 dokumente, 300 dëshmitarë që duhet
5 t'i shqyrtojmë dhe më shumë se 3.000 dokumente të tjera për t'i
6 rishqyrtuar. Dhe është vështirë të bësh lidhjen midis tyre. Dhe
7 meqenëse dhe Prokuroria po thotë që ka bërë njëfarë lidhje midis
8 dëshmimeve dhe dëshmitarit, do të ishte mirë ta bënte këtë gjë në
9 kohën që na e jep materialin.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, ju lutem.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
12 Gjykatës, unë komentova në krye kur fola që kjo që po themi tani
13 lidhet në njëfarë mase me pikën e parë të programit të sotëm. Dhe
14 unë e miratoj, në kuptimin që në mungesë të hollësive në listën e
15 dokumenteve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Prokurorisë në bazë
16 të rregullës 109, kjo bëhet dhe më e vështirë në mungesë të
17 dokumenteve.

18 Dua të fokusohem në një aspekt të listës. Ju e dini që në
19 seanca të tjera unë e kam prekur shumë shkurtimisht procesin e
20 bërjes së listave, sepse parashikoja që Prokuroria kur të na jepte
21 dokumentet do të na i bënte të njohura në mënyrën e duhur, por
22 lista është mënyra më e mirë të themi, në këto kushte, për të
23 treguar se cili dëshmitar lidhet me cilin incident dhe jo me pikën
24 e aktakuzës.

25 Dua të fokusohem në një pikë që është dhe subjekt i

1 mosmarrëveshjeve. Po kthehem pak pas për të shpjeguar se çfarë do
2 të thotë kjo. Unë thashë që shumë materiale na janë dhënë pa asnjë
3 udhëzim dhe unë u kritikova se nuk isha i drejtë me Prokurorinë kur
4 fola.

5 Por po ju jap një shembull. Pra, materialet po na bëhen të
6 ditura në një masë shumë të madhe. Dhe Prokuroria duhet ta dijë -
7 dhe unë e kuptoj pse e ka kaq të vështirë të përmbushë detyrimin e
8 saj, në përputhje me funksionet e saj bazë - Prokuroria duhet ta
9 dijë se me kë lidhet një dëshmitar, duhet ta dinë me çfarë
10 incidenti, me çfarë vendndodhje apo vendngjarje dhe me çfarë
11 ngjarje konkrete pavarësisht nga pikat e aktakuzës, sepse ato
12 lidhen në përgjithësi me incidentet që kanë ndodhur në 34 vende.

13 Ata duhet ta dinë, pra, Prokuroria, ndryshe nuk do t'i
14 paraqisnin materialet kështu siç po i paraqesin. Ata e dinë që kur
15 çështja u parashtreu përpara jush për konfirmim, unë nuk e di, po
16 supozoj që juve ju kanë dhënë njëfarë udhëzimi lidhur me materialin
17 që e tejkalonte aktakuzën.

18 Por këtu po ndiqet një praktikë krejt tjetër krahasuar me
19 tribunalët e tjerë lidhur me hollësitë e aktakuzës. P.sh.,
20 aktakuzat e TPNJ-së ishin të ngjashme me një dosje paragjyqësore,
21 pra, përshkruheshin incidentet. Sigurisht mund të redaktoheshin
22 emrat e dëshmitarëve, por kishe një shpjegim të plotë të lidhjes së
23 çdo dëshmitari me çdo akuzë. Kurse këtu s'kemi asnjë nga këto.

24 Dhe ato që thotë Prokuroria është se do ta marrim këtë udhëzim
25 kur ata të dorëzojnë dosjen paragjyqësore. Por nuk duhet ta bëjnë

1 atëherë, duhet ta bëjnë përpara. E bëjnë këtë sepse nuk e dinë? Mua
2 më duket e vështirë ta besoj. Apo sepse duan ta mbajnë këtë
3 informacion nga Mbrojtja? Nuk ka shumë rëndësi, se sido që të jetë
4 puna, Mbrojtja nuk mund të fillojë punën për hetimet pa u njohur me
5 çështjen e Prokurorisë.

6 Pra, kjo është pika e parë e mosmarrëveshjes sonë që ju e
7 identifikuat si çështje teknike. Por unë nuk e quaj thjesht çështje
8 teknike, siç po e trajton mbase Prokuroria. Unë e quaj atë si një
9 çështje që lidhet me drejtësinë e këtij procesi. Jo thjesht
10 çkategorizimi apo ndarja, por edhe mungesa e përshkrimit të duhur
11 të çështjes nga ana e Prokurorisë.

12 Në dritën e qëndrimit që po mban Prokuroria, që siç thashë,
13 nuk përputhet me funksionet bazë të ZPS-së, që unë e quaj si një
14 argument për burimet, pra, Prokuroria do të thotë që nuk është gati
15 ta paraqesë çështjen e vetë. Në qoftë se është kështu, unë do t'ju
16 sugjeroja, i nderuar Gjykatës, që ju të urdhëroni një datë të
17 hershme të dorëzimit nga Prokuroria të dosjes paragjyqësore. Pra,
18 ta dorëzojë në fillim p.sh., të prillit.

19 Sigurisht, mund të ndryshohet në qoftë se dalin prova të reja.
20 Pra, po të dorëzohet kjo bashkë me përmbushjen e boshllëqeve që po
21 i mban qëllimisht Prokuroria nga ne, atëherë mund të fillojmë të
22 flasim për hetimet tona si Mbrojtje dhe për planifikimin e
23 gjykimit.

24 Por për momentin Prokuroria po na vë në një pozitë që të
25 futemi në një pyll që s'ka rrugëdalje, pra, pa hartë. Në qoftë se

1 nuk e bëjnë nëpërmjet listave të dokumenteve që do të ishte mënyra,
2 të themi, më e mirë në këto kështu, juve do t'ju sugjeroja që t'u
3 jepni udhëzime, që ju besoj jua kanë dhënë në procesin e
4 konfirmimit në formën që parashikon rregullorja. Dhe kjo t'i
5 jepet, pra, kjo dosje paraprake t'i jepet Mbrojtjes në formë
6 fillestare në fillim të prillit. Dhe kjo, sigurisht, siç thashë,
7 mund të ndryshohet kur Prokuroria siguron prova të tjera. Dhe unë
8 po e paraqes këtë provë -- këtë propozim për ta vendosur në
9 agjendë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Young.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit. Nuk
13 kemi ç'të shtojmë. Ne parashtrojmë që jemi në një rrugë pa krye dhe
14 duhet të ndërhyjnë ju dhe të jepni një vendim për këtë çështje,
15 ndryshe nuk ecim dot përpara.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

17 Znj. Alagendra apo z. Ellis.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ellis do të
19 flasë për këtë çështje.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis, ju lutem.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] E kemi parashtruar
22 këtë çështje në parashtrimet tona me shkrim dhe i përmbahemi atyre.

23 Ju dëgjuar ankesën e përgjithshme të ekipeve të Mbrojtjes
24 lidhur me mënyrën sesi materialet na janë hedhur ne në prehër, si
25 të thuash, pa përgatitjet e duhura. Është shembull i mënyrës sesi

1 Prokuroria mund të përmirësojë punën e vetë dhe të na japë ne si
2 Mbrojtje ndihmë të dobishme për të punuar me materialet e shumta që
3 na janë dhënë.

4 Por, nuk e di për ç'arsye, Prokuroria nuk dëshiron ta bëjë
5 këtë deri kur të paraqesë dosjen paraprake që, siç thonë ata, do të
6 kërkojë disa muaj. Ne mendojmë që nënndarjet apo kategorizimet mund
7 të jepen në çdo paketë që ata do të japin, me qëllim që ta përdorim
8 sa më mirë për hetimet tona dhe për të kuptuar materialin që na
9 jepet.

10 Përveç kësaj, ne do të -- i përmbahemi, siç thashë,
11 parashtrimeve tona me shkrim.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

13 Tani po i drejtohem Prokurorisë. Dua konkretisht të flisni për
14 dy gjëra. Pyetjet që kam pasur unë në fillim. Çfarë ndikimi konkret
15 do të kishte në afatin kohor, dhe është e rëndësishme dhe nëse
16 mbase mund të flisnit për mosmarrëveshjet, jo për të gjitha, por
17 ato më të rëndësishmet të paktën. Nëse do të kërkohet që të shtojmë
18 disa nënkategori apo rregulli -- kjo tabela në bazë të rregullës
19 109(c) të jepet në mënyrë më të rregullt përpara sesa të jepni
20 dokumentet apo përpara dosjes paraprake.

21 Dhe së dyti, dua që të flisni për propozimin e z. Emmerson që
22 të dorëzoni dosjen paraprake më herët sesa ju e kishit parashikuar,
23 që t'i jepni mundësi Mbrojtjes të përfitojë nga tabelat e rregullës
24 109.

25 Keni fjalën znj. Prokurore.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

2 Besoj më duket se Mbrojtja e Selimit tha që jemi në një rrugë
3 pa krye. Ashtu është, një rrugë pa krye midis ideale dhe
4 praktikës.

5 Propozimi i ZPS-së përputhet me rregullën 109(c), dhe po
6 diskutojmë se çfarë mund të bëhet përtej këtyre kërkesave. Ne e
7 kemi ngritur argumentin e burimeve sepse në fakt është baza e asaj
8 që mund të bëjë zyra jonë në praktikë.

9 Lidhur me Mbrojtjen, parashtrimet e Veselit, po i drejtoj
10 përsëri te rregulla 86(3) dhe te procesverbali i parashtrimeve në
11 këtë çështje, të cilat janë të disponueshme dhe i janë dhënë -- në
12 bazë të rregullës 86(3)(b) ju janë dhënë juve dhe Mbrojtjes.

13 Tani t'i kthehem çështjes apo pyetjes që ju sapo bëtë, i
14 nderuar Gjykatës, lidhur me kohën, afatin kohor.

15 Nënkatëgorizimi në bazë të rregullës 102(1)(b), varet nga
16 përgatitja e dosjes paraprake. Duke pasur parasysh afatin kohor që
17 është përcaktuar, është vendosur, do të duhet disa muaj përpara se
18 kjo dosje të jetë në një fazë të tillë që të mundësojë prodhimin e
19 tabelës, e cila është projektuar dhe propozuar duke pasur këtë gjë
20 në mendje.

21 Lidhur me rregullën 103, është e vërtetë që nuk kam pasur
22 mundësi t'i jap -- nuk i dhashë Trupit Gjykues ndonjë indikacion
23 lidhur me vonesat, p.sh., numrin e muajve. Dhe kjo vjen për shkak
24 të faktit se kjo detyrë nuk mund të bëhet ndërkohë që përmbushim
25 funksionet tona bazë, përfshirë nxjerrjen -- detyrimin për

1 nxjerrjen e materialit, për këtë dhe për çështje të tjera. Për ta
2 bërë këtë në një mënyrë që përputhet me materialet shfajësuese që
3 duhen bërë të njohura. Pra, në fakt është një gjë që kërkon një
4 periudhë të gjatë kohe.

5 Besoj që ju përgjigja pyetjeve tuaja, i nderuar Gjykatës, po
6 nëse lashë ndonjë gjë pa thënë, ju lutem ma vini në dukje.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

8 Z. Emmerson, ju lutem.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Vura re se nuk u
10 përgjigj për sugjerimin që Prokuroria duhet të urdhërohet që të
11 dorëzojë dosjen paraprake më 1 prill.

12 Më lejoni të shtoj dhe një gjë, dhe këtë e kam në formë
13 kërkesë, i nderuar Gjykatës. Më lejoni të shtoj diçka? Është e
14 qartë se Prokuroria po thotë që përmbushja e detyrimit që ne
15 kërkojmë në lidhje me pikën e parë, pra, përcaktimin e vendit,
16 kohës, e kështu me radhë të incidenteve të ndryshme, është e qartë
17 se minimalisht Prokuroria e konsideron këtë nga pikëpamja praktike,
18 në bazë të burimeve të veta, që lidhet në mënyrë të paevitueshme me
19 datën e dosjes paraprake. Në qoftë se është kështu vërtet, atëherë
20 ne duhet të punojmë në bazë të këtij realiteti.

21 Por siç tha -- kur, siç tha Prokuroria, t'ia japë këtë
22 informacion Mbrojtjes, kjo nuk përputhet me kryerjen e funksioneve
23 të saj bazë. Në këtë rast mendoj se ju duhet t'i kujtoni se
24 funksioni bazë i tyre është që t'ia bëjë të njohur çështjen qartë
25 Mbrojtjes. Kjo është një nga funksionet themelore. Dhe duket se

1 Prokuroria ka humbur rrugën në proces. Ka humbur nga sytë
2 objektivin kryesor, qëllimin kryesor, që është t'i japë mundësi
3 Mbrojtjes ta kuptojë çështjen që duhet të trajtojë.

4 Meqenëse nuk i është dhënë përgjigje e drejtpërdrejtë - dhe
5 unë po ju ftoj që të nxirrni konkluzione në lidhje me Prokurorinë -
6 e di që ju kërkuat konkretisht përgjigje dhe nuk morët një
7 përgjigje, mbase duhet t'i jepni dhe njëherë mundësinë Prokurorisë
8 t'ju japë përgjigje.

9 Por kur thotë se nuk mund t'ju japim afat pa kaluar javë,
10 muaj, kam frikë se po thonë se duhet ndërhyrje gjyqësore, sepse nuk
11 jemi në gjendje t'u themi se kur do të jemi gati. Në këtë rast e
12 keni ju për detyrë t'i vendosni një datë Prokurorisë për të
13 deklaruar çështjen e saj, meqenëse Prokuroria ka thënë që nuk e
14 bëjmë dot para se ta përfundojmë dosjen paragjyqësore.

15 E kuptoj, sepse duhen ta formulojnë çështjen si duhet përpara
16 sesa të thonë konkretisht cili dëshmitar është ai që duhet -- është
17 relevant. Pra, kur të kemi dosjen në dorë ne mund të themi
18 konkretisht se çfarë mund të bëjmë ne lidhur me këtë afat.

19 Kam frikë se është e nevojshme që një gjykatës të nxjerrë
20 kamxhikun dhe ta qëllojë Prokurorinë në këtë rast për të bërë punën
21 e saj, sepse ndryshe ata do të rrinë pesë vjet për të përgatitur --
22 ata kanë pasur pesë vjet për të përgatitur çështjen. Kështu që do
23 të ishte mirë nëse na e jepnin ne mundësinë të planifikojmë një
24 datë për gjykimin.

25 Pa u bërë kjo, ne po presim dhe nuk po bëjmë atë që duhet.

1 Prandaj ju sugjeroj që ky parashttrim kërkon një përgjigje më të
2 menduar dhe jo thjesht një përgjigje të shpejtuar nga Prokuroria.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonjusha Lawson, doni t'i
4 përgjigjeni z. Emmerson në lidhje me këtë?

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, faleminderit.

6 Është e pasaktë që Prokuroria nuk e ka parashtuar çështjen e
7 saj. Ne e kemi bërë këtë shumë qartë në aktakuzë dhe në
8 përmbledhjen e detajuar, sipas rregullës 86(3)(b), që unë për herë
9 të tretë i ftoj avokatët që ta lexojnë.

10 Për sa i përket kohës se kur do të dorëzohet dosja paraprake,
11 do ta trajtoj këtë çështje kur të jetë kjo pikë e rendit të ditës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, kalojmë në pikën tjetër
13 të rendit të ditës, që janë hetimet e Zyrës së Prokurorit të
14 Specializuar.

15 Tani i kthehem përsëri Prokurorisë të na thotë se ku janë me
16 hetimet e tyre. A është vlerësimi i datës korrik 2021 i saktë për
17 sa i përket dosjes paraprake dhe dorëzimit të saj, dhe nën dritën e
18 masave -- e vendimit për masa mbrojtëse dhe kalendarit për
19 nxjerrjen e materialeve?

20 E theksoj që sot nuk do të dëgjoj parashtime në lidhje me
21 datën e gjykimit. Pra, pika tjetër e rendit të ditës që do të
22 diskutojmë ka të bëjë me dosjen paraprake.

23 Z. Prokuror.

24 Z. SMITH: [Përkthim] Desha të them në fillim se me qëllim nuk
25 kam dashur t'i drejtohem Gjykatës drejtpërsëdrejti sepse ne kemi

1 prokurorë shumë të aftë që i trajtojnë këto çështje dhe e njohin
2 çështjen shumë mirë. Dhe ju siguroj, i nderuar Gjykatës, që kjo nuk
3 do të jetë praktikë e zakonshme, që unë do të flas në Gjykatë.

4 Por, mbasi del një çështje shumë e rëndësishme dhe kur më
5 takon mua personalisht që ta sqaroj pozitën e zyrës tonë, do të
6 kërkoj ta sqaroj këtë gjë.

7 Çështja se kur do të jepet dosja paraprake. Dhe nuk do ta
8 trajtoj këtë çështje sot, por kjo është e lidhur edhe me datën e
9 gjykimit, janë çështje të lidhura me njëra-tjetrën pra. Siç e di
10 Gjykata, nga Konferencat e mëparshme për Ecurinë e Çështjes, që ne
11 kemi mosmarrëveshje shumë të forta midis Mbrojtjes dhe Prokurorisë
12 në lidhje me këtë. Dhe megjithëse unë jam krejtësisht në mospajtim
13 me pikëpamjen e Mbrojtjes, e mbështes të drejtën e tyre për të
14 ngritur këto argumente.

15 Sigurisht, është në avantazhin e tyre të kenë dosjen paraprake
16 dhe pastaj, më vonë të bëhet gjykimi. Megjithatë, ka një dallim
17 midis të drejtës për të ngritur një argument dhe të bësh një
18 argument që nuk mbështetet nga logjika dhe nga faktet.

19 Në Konferencat e mëparshme për Ecurinë e Çështjes dhe sot, unë
20 i kam dëgjuar ata që janë përpjekur të fajësojnë punën e bërë nga
21 Prokuroria, dhe thonë që kanë argumente sepse duam një gjykim të
22 shpejtë. Unë kam një qasje tjetër, sepse nuk besoj që personalizimi
23 i çështjeve është argument i fortë.

24 Z. Emmerson flet për juridiksionet ku është mësuar ai. Ai
25 është mësuar që si avokat - dhe besoj ai e di këtë - që si avokat

1 po të bërtasësh më shumë, po ta ngresh zërin më shumë në mënyrë më
2 agresive, nuk është mënyra për t'i fituar çështjet. Aty ku e
3 praktikoj unë profesionin tim, ne nuk e praktikojmë profesionin e
4 avokatit në këtë mënyrë.

5 Unë e ftoj Gjykatën që të vërejnë se kur ndodh kjo në sallën e
6 gjyqit, kjo është një shenjë që ata nuk po flasin për fakte dhe nuk
7 po mbështesin argumente. Në këtë çështje të dosjes paraprahe, në
8 qoftë se ndahen bazat apo thelbësia e argumentit të Mbrojtjes nga
9 gjuha inflamatore që përdoret dhe kërcënimet që përdor ai, dhe po e
10 them fjalën "kërcënime". Dy herë sot e ka bërë z. Emmerson këtë.

11 Gjykata duhet të shikojë faktet dhe ligjin, dhe mendoj që
12 është detyra e Prokurorisë që këto të zbatohen.

13 Unë dua ta bëj të qartë, e kam bërë të qartë edhe në
14 parashtrimet me shkrim, po dua ta bëj të qartë edhe sot që është e
15 rëndësishme që t'i jepet Mbrojtjes koha dhe burimet për t'u
16 përgatitur për gjykim. Kjo është domosdoshmëri. Është në interesin
17 tonë, është dhe në interesin e Mbrojtjes që të kenë kohën dhe
18 burimet e tyre.

19 Por kjo Gjykatë ka dhe konsiderata të tjera për të marrë
20 parasysh kur cakton datën e gjyqit apo kur do të dorëzohet dosja.

21 E para, janë viktimat në këtë rast dhe dëshmitarët në këtë
22 rast që po presin të bëhet drejtësia dhe kanë pritur me vite për
23 këtë. E dyta, është realiteti. Realiteti që kemi një orë e gjysmë
24 këtu dhe nuk është përmendur fare. Realiteti i frikësimit të
25 dëshmitarëve. Ky është realiteti i kësaj çështjeje dhe do të mbetet

1 realitet. Dhe është fakt që ka një hendek të madh midis dorëzimit,
2 apo nxjerrjes të të gjithë dokumenteve dhe datës së gjyqit, sepse
3 kjo do të rrezikojë dëshmitarët. Kjo është e vërteta dhe për këtë
4 nuk është folur.

5 Sigurisht janë vendosur masa mbrojtëse, janë redakteime që i
6 janë bërë dokumenteve, po duhet të kuptohet që këto janë mjete për
7 të zvogëluar rrezikun, por nuk e heqin, eliminojnë rrezikun
8 komplet. Pra, duhet t'i themi të gjitha këto të vërteta ashtu siç
9 janë. Dhe në qoftë se lihet kohë, muaj të tërë që nga koha e
10 dorëzimit të dosjes paraprake deri te data e gjyqit, atëherë ne nuk
11 do t'u shërbejmë këtyre dëshmitarëve dhe viktimave.

12 Dua të them gjithashtu, i nderuar Gjykatës, që znj. Lawson
13 foli për shkallën e nxjerrjes së materialeve dhe strukturën e
14 nxjerrjes së materialeve që ne do t'i përmbahemi. Procedurat e
15 nxjerrjes së materialeve këtu janë po aq strikte sa në të gjitha
16 gjykatat e tjera ndërkombëtare. Ato dallohen nga gjykata të tjera
17 kur p.sh., faza përgatitore ka marrë shumë kohë. Kjo Gjykatë duhet
18 të veprojë më mirë, të veprojë më mirë në interes të viktimave dhe
19 dëshmitarëve dhe të popullit të Kosovës.

20 Unë dua të vë në dukje gjithashtu, edhe çështjen e burimeve
21 dhe kapaciteteve që ka në dispozicion Mbrojtja, sepse është unike
22 kjo gjë. Ata kanë thënë që ju duhen vite për ta hetuar këtë
23 çështje. Fakti është që ekipet e Mbrojtjes kanë po aq burime sa
24 edhe gjithë ekipet e tjera të Mbrojtjes në gjykata të tjera. Dhe
25 qeveria e Kosovës ka dhënë 20 milion, ka alokuar 20 milion euro për

1 mbrojtjen e të akuzuarve. Po kështu edhe Zyra Administrative ka
2 fonde në qoftë se do të jetë nevoja.

3 Gjykata e di që nuk kërkon të bëhet sot një diskutim i gjatë
4 në lidhje me datën e gjyqit, por ne ju sigurojmë që ne do të
5 përdorim çdo mjet që është i mundur që kjo çështje të ecë përpara.
6 Dhe ne themi që data e dorëzimit të dosjes duhet të lidhet me datën
7 e fillimit të gjykimit duke i dhënë mundësi atyre që të përgatiten,
8 dhe do të jetë një mjet menaxhimi për Gjykatën në ecjen përpara të
9 kësaj çështjeje.

10 Në qoftë se Gjykata vendos kundër Mbrojtjes në këtë çështje,
11 Mbrojtja ka dhënë çdo indikacion që ata do t'i bëjnë qëndresë
12 urdhrave të Gjykatës. Unë kam frikë se Mbrojtja po përpiqet ta
13 vonojë këtë çështje dhe do ta realizojë këtë në qoftë se vazhdojnë
14 të veprojnë kështu.

15 Duke pasur parasysh historinë e frikësimit të dëshmitarëve, ne
16 këtë duhet ta kemi gjithmonë në qendër të vëmendjes kur bëjmë
17 parashtrimet tona.

18 Çështja e dosjes paraprake është e përbërë nga disa çështje,
19 të cilat -- disa prej tyre i kemi diskutuar sot. Në secilën prej
20 këtyre çështjeve gjyqësore, Mbrojtja ka marrë pozicionin që
21 historia kufizon të ardhmen. Çfarë ka ndodhur në të kaluarën do të
22 përcaktojë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Vetëm për faktin që
23 diçka ka ndodhur në të kaluarën, pra, janë dashur vite të tëra për
24 të argumentuar një çështje në gjyq përpara, kjo nuk do të thotë që
25 ashtu duhet vepruar.

1 Kohëzgjatja e procedurave në gjykatat penale ndërkombëtare
2 është kritikuar dhe është problem, dhe kjo e pengon apo e dëmton
3 besueshmërinë e disa institucioneve dhe rezultatet që nxjerrin ato.
4 Pra, ne nuk duhet të mendojmë që ta bëjmë tavanin dysHEME. Ne duhet
5 të përpigemi të realizojmë atë që i ka vënë detyrë vetes kjo
6 Gjykatë, që të bëjë procedura efikase.

7 Duhet të them këtu se nuk e kuptoj kur dëgjoj fjalët që thotë
8 z. Emmerson, që çështja jonë është një çështje e ndërtuar prej
9 letre dhe provat nuk janë të forta, pavarësisht nga ato që përmendi
10 znj. Lawson. Dhe në të njëjtën kohë, z. Emmerson dhe
11 bashkëmbrojtësit e tjerë kanë argumentuar këtu që ju duhen vite të
12 tëra për të përgatitur një çështje gjyqësore që ata thonë është e
13 ndërtuar prej letre. Kjo s'ka kuptim.

14 Në paraqitjen e parë, z. Emmerson dha një prezantim të
15 detajuar dhe shumëkahësh të mbrojtjes së z. Veseli. Kjo u bë edhe
16 përpara sesa Prokuroria t'i kishte dhënë ndonjë material. Një
17 prezantim i tillë si ai, nuk do të ishte i mundur në qoftë se bota
18 do të ishte ashtu siç pretendon Mbrojtja.

19 Realiteti është që të akuzuarit vetë i kanë ditur akuzat
20 kundër tyre, edhe për mjaft kohë madje, dhe pavarësisht nga
21 protestimet e tyre për të kundërtën, ata kanë kohë të mjaftueshme
22 për t'u përgatitur për çështjen.

23 Pra, në përfundim desha të them që secili prej të akuzuarve ka
24 thënë me forcë shumë qartë edhe shumë publikisht se janë të
25 pafajshëm. Unë dua ta bëj të qartë që atyre nuk iu kërkua ta bënim

1 këtë. Dhe dua të them edhe që i takon barra e provës zyrës time që
2 ta provojë çështjen kundër tyre. Kështu duhet të jetë. Kështu është
3 dhe kështu duhet të jetë.

4 Megjithatë, më duket shumë e çuditshme që jam ngritur këtu
5 para jush sot edhe po luftoj që t'i jap atyre mundësinë që të kenë
6 ditën e tyre në Gjykatë, ditën e tyre triumfatore në Gjykatë dhe të
7 paraqesin çështjen e tyre. Kjo nuk është pjesë e barrës tonë, të
8 punës tonë.

9 Pra, në përputhje me parashtrimet që kemi bërë përpara, ne
10 jemi për një gjykim sa më të shpejtë. Të caktohet një datë për
11 gjykimin, e cila do të lidhet me datën e dorëzimit të dosjes
12 paraprake dhe që përputhet me historitë e kaluara, apo me çfarë
13 është bërë në gjykata të kaluara më parë. Unë do të thosha që
14 caktimi i një date gjykimi e cila është e lidhur me dorëzimin e
15 dosjes paraprake, është mënyra më e mirë për ta menaxhuar këtë
16 çështje, është mënyra më e mirë që të ketë një gjykim të drejtë për
17 të akuzuarit dhe të ketë drejtësi për Kosovën.

18 Dhe unë kam besim që kjo mund të bëhet duke respektuar
19 plotësisht të drejtat e të pandehurve.

20 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

22 A mund përkthyesit nëse mund të vazhdojnë edhe nja dy minuta
23 në mënyrë që të kemi përgjigjet e Mbrojtjes dhe pastaj do të bëjmë
24 një --

25 Atëherë, t'i kërkoj Mbrojtjes të japin mendimet e tyre. Po ju

1 lutem shkurt sepse përkthyesit kanë punuar për një kohë të gjatë
2 tani, dhe ju duhet të bëjnë pak -- të bëjnë pushim në mënyrë që të
3 jenë sa më të saktë dhe eficientë që të jetë e mundur.

4 Z. Hooper.

5 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ah, para pak u
6 gëzova shumë kur na ngritën atë kartonin e verdhë për të gjithë ne
7 kur përmendëm çështjen e datës së gjykimit. Dhe pastaj çohet z.
8 Smith edhe bën këtë faull para të gjithëve ne.

9 Tani, unë e kuptoj që z. Smith ka ardhur këtu me një deklaratë
10 të përgatitur dhe ai po drejton punën e zyrës së vetë, por ndoshta
11 po të kishte pasur më shumë fokus do të na kishte ndihmuar më shumë
12 në këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjes.

13 Z. Smith mendon që sistemi i nxjerrjes së materialeve është
14 sistemi më i mirë i mundshëm, por në qoftë se ai e vë veten në
15 pozitën tonë, do ta kuptojë shumë shpejt që nxjerrja e materialeve
16 nuk është, ose është më pak funksionale dhe më pak e mjaftueshme
17 apo e përshtatshme sesa në institucione të tjera me të cilat e kemi
18 krahasuar.

19 Sot kemi folur për një mënyrë sesi ta balancojmë këtë. Jo me
20 objektivin për ta shtyrë datën e gjyqit, që është bërë si slogan i
21 Prokurorisë, kjo është thjesht që ne të nxjerrim informacionin që
22 na duhet nga çështja dhe nga materialet.

23 Dhe është sugjeruar se çdo gjë tjetër s'ka funksionuar në
24 sistemin e Prokurorisë dhe tani na ka mbetur vetëm kjo tabelë për
25 të na ndihmuar për të gjetur informacionin që na duhet, apo

1 materialet që ende nuk janë nxjerrë. Prokuroria ishte kundër kësaj,
2 e kundërshtoi këtë, siç e dëgjuam. Dhe nën dritën e kësaj, siç e
3 tha kolegu im, mbrojtësi i z. Veseli, pse atëherë të mos dorëzohet
4 dosja paraprake përpara?

5 Edhe nuk e kuptoj këtë argument të lidhjes së dosjes paraprake
6 me datën e fillimit të gjyqit. Në qoftë se e kanë shqetësimin, siç
7 tha z. Smith, për mbrojtjen e dëshmitarëve etj., atëherë pse mos të
8 japin një dosje paraprake të redaktuar?

9 Ne e dimë që në këtë Gjykatë shumë kohë para sesa ne të
10 angazhoheshim në këtë çështje, shumë kohë më para sesa të
11 angazhohej dhe vetë Prokuroria që ka frikësim të dëshmitarëve,
12 frikësim të dëshmitarëve, frikësim të dëshmitarëve. Nuk do t'i hyj
13 kësaj sepse është më tepër një slogan sesa ka të bëjë me realitetin
14 e vërtetë të çështjes. Pra, kjo është një çështje që është për
15 katër të akuzuar. Jo të gjithë prej tyre kanë pasur përvojat që
16 përmendi z. Smith.

17 Pra, ku jemi? Unë jam shumë mirënjohës që ju, i nderuar
18 Gjykatës, ngritët kartonin e verdhë për sa i përket datës së
19 gjykimit dhe nuk doni që kjo të diskutohet. Nga ana jonë, dhe besoj
20 flas në emër të të gjithë mbrojtësve, ne duam të sigurojmë se nuk
21 bëhet fjalë për të diskutuar datën e gjykimit derisa të jetë koha e
22 duhur për ta bërë një gjë të tillë. Dhe ju, i nderuar Gjykatës, do
23 të na njoftoni në mënyrë që të gjithë të kemi mundësinë të
24 kontribuojmë në mënyrë pozitive dhe të frytshme në atë diskutim.

25 Kaq kisha për të diskutuar. Kaq ishin komentet e mia në lidhje

1 me këtë çështje.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

3 Z. Emerson.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do të flas sa më
5 shkurt që të jetë e mundur. Z. Smith foli për kaq shumë gjëra të
6 cilave unë do të doja t'i përgjigjesha.

7 Së pari, duhet të them se prania dhe kontributi i tij në këtë
8 diskutim e ka çuar çështjen përpara në shumë drejtime që unë do t'i
9 identifikoj pas pak. Por ka hedhur dritë të paktën mbi taktikat që
10 përdor Prokuroria për trajtimin e kësaj çështjeje.

11 Unë desha të përmend këtë që unë kam bërë sulme personale *ad*
12 *hominem*. Z. Smith dhe ekipi i tij e dinë se cili është dallimi
13 midis një sulmi mbi sjelljen dhe etikën e Prokurorit, ose të
14 Prokurorisë dhe sulmin mbi personin, që z. Smith është Prokurori
15 dhe është përgjegjës për kryerjen e punës së ZPS-së. Dhe ai ndoshta
16 e ndjen personalisht sulmin që po i bëj unë ZPS-së, megjithatë, e
17 ka të drejtën Mbrojtja që të vërë në dukje keqsjelljet apo
18 strategjitë që përdor pala tjetër kur ata shohin se janë -- e
19 pengojnë administrimin e drejtësisë.

20 Nuk ka asnjë gjë të personalizuar në këtë, dhe shpresoj që e
21 kam bërë krejt të qartë që Prokuroria nuk i ka përmbushur
22 standardet bazë të sjelljes së vetë dhe të punës së vetë.

23 Së dyti. Derisa foli z. Smith -- e thashë z. Black, më falni.
24 Pra, derisa foli z. Smith, parashtimi im ishte vazhdimisht që
25 Prokuroria po përpiqet të heqë Mbrojtjen nga rruga e duhur dhe ta

1 shmangë atë nga objektivi i vërtetë. Dhe unë them që mbi bazën e
2 kësaj, unë kam nxjerrë përfundimin që nuk është sjellje etike nga
3 ana e tyre. Pra, që nuk i lejohet Mbrojtjes të ketë mjetet dhe
4 burimet e mjaftueshme.

5 Por sigurisht ka edhe shpjegim tjetër, që Prokuroria nuk e
6 sheh më funksionin e vetë thelbësor që është drejtësia e
7 procedurës. Ata janë kaq partizanë dhe kaq të anshëm nga njëra anë
8 saqë nuk i marrin parasysh më interesat e drejtësisë dhe interesat
9 e të akuzuarve. Prokuroria thjesht, jo se e ka bërë me keqbesim,
10 por thjesht nga entuziazmi në projektin e tyre -- për projektin e
11 tyre, kanë humbur tani objektivin e funksionit të vetë kryesor.

12 Pra, ajo që na tha, sapo na tha z. Smith e sqaron çështjen
13 përtej dyshimit të arsyeshëm edhe sa më të vogël, pra, që ai sapo
14 na thotë që Prokuroria po krijon një situatë ku Mbrojtja nuk ka
15 nevojë të dijë se çfarë akuzash janë ngritur derisa -- deri në
16 momentin e fundit të mundshëm, deri tre muaj para gjyqimit.

17 Ai na e tha këtë sepse justifikohet nga nevoja për të mbrojtur
18 viktimat dhe dëshmitarët dhe që të akuzuarit të kenë kohën më të
19 paktë të mundshme për t'u përgatitur. Sapo na e tha. Pra, nuk ka
20 nevojë të kemi dyshim më se Prokuroria po përpiqet qëllimisht që të
21 krijojë një situatë që të mos na e japë informacionin që na duhet
22 për t'u përgatitur. Dhe në këtë fazë ata duan që të mos na e japin
23 këtë informacion pavarësisht nga çdo gjë, të mos na e japin këtë
24 informacion deri tre muaj para datës së gjyqit.

25 Pra, ndërhyrja e tij ishte -- na ka bërë që çështja të ecë

1 përpara. Nuk është çështje mungese profesionaliteti apo mosnjohje e
2 balancës së duhur të administrimit të drejtësisë, apo ku është kjo
3 balancë. Tani që z. Smith, u çua në këmbë dhe e pohoi vetë me gojën
4 e vetë, është e qartë që Prokuroria e ka si politikë që të pengojë
5 Mbrojtjen në mbrojtjen e klientëve të vetë.

6 Dhe kjo nuk shpjegohet vetëm me mbrojtjen e dëshmitarëve,
7 sepse edhe pas asaj do të ketë redakte, do të ketë anonimizim të
8 dëshmitarëve që do të paraqiten në gjyq. Pra, në çfarëdo faze mund
9 të bëhen redakte për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në fakt, ajo që
10 thotë ai se dhënia e dokumenteve të redaktuara në njëfarë mënyre do
11 të dëmtojë dëshmitarët, është gjepura. Pra, dëshmitarët në këtë
12 çështje nuk janë frikësuar nga askush.

13 Pra, unë them që në qoftë se do të kishin dhënë p.sh., lirimin
14 e katër dëshmitarëve përkohësisht, nuk e di, d.m.th., ndoshta ajo
15 mund të kishte një -- do të ishte një çështje tjetër, që ata
16 ndoshta mund -- kolektivisht të kishin rrezikun e komunikimit me
17 mbështetësit e tyre etj. Por deri më sot nuk ka asnjë lloj prove që
18 të mbështesë sugjerimin dramatik të z. Smith. Dhe ajo që thotë z.
19 Smith se është e drejtë, pra, që të mos i japë informacion
20 Mbrojtjes deri në momentin e fundit para gjykimit, kjo nuk është e
21 vërtetë dhe tregon politikën që po ndjekin ata. Dhe shpjegon të
22 gjitha vendimet që kanë marrë deri tani që kanë qenë joetike dhe të
23 paduhura. Kjo bëhet me qëllim dhe bëhet për të na penguar ne.

24 Pra, ju, i nderuar Gjykatës, jeni gjyqtari në këtë ring, dhe
25 ju duhet të jepni vendimet tuaja. Është në interes të drejtësisë që

1 Mbrojtjes t'i lejohet të bëjë një gjykim të drejtë. Nocioni është i
2 mjaftueshëm, pra, nocioni që tre muaj janë të mjaftueshëm për të
3 bërë gjykimin është krejtësisht i pavërtetë dhe i gabuar.

4 Pra, në këto rrethana, ju keni frenat në dorë dhe mund ta
5 frenoni Prokurorinë. Ju do të vendosni sesi do të trajtohet kjo
6 çështje. Dhe duket që Prokuroria e ka si politikë që të vonojë sa
7 më shumë që të jetë e mundur dhënien e të gjitha materialeve në
8 mënyrë që të mos i lejojë Mbrojtjes të përgatitet deri tre muaj
9 para gjykimit.

10 Ne e kuptojmë që Prokuroria ka vendosur që do ta lidhë
11 nxjerrjen e informacionit që i kemi kërkuar ne me datën e gjykimit.
12 Dhe tani parashtrimi i tyre është shumë i qartë, që faleminderit --
13 i themi z. Smith: Faleminderit, ne e dimë, e kuptojmë sepse jeni
14 sjellë kështu si jeni sjellë deri tani. Ne e pranojmë nën dritën e
15 shpjegimit tuaj se kjo nuk tregon mungesë etike në punën tuaj apo
16 që nuk i keni kushtuar vëmendjen e duhur detyrave tuaja.

17 Por është e rëndësishme që Gjykatësi të vendosë balancën. Dhe
18 në këto rrethana duam që ju të përcaktoni datën e dhënies së dosjes
19 paraprake diku nga 1 prilli, në fillim të prillit, dhe pastaj
20 Mbrojtja mund të vazhdojë me përgatitjet e veta.

21 Por unë e falënderoj z. Smith që përmendi atë diçkanë që nuk
22 ishte përmendur deri tani. Jo vetëm politika e Prokurorisë është
23 drejtuar nga ky shqetësim për mbrojtjen e dëshmitarëve, po tani ata
24 e kanë pranuar zyrtarisht në procesverbal se kjo është politikë e
25 tyre për të penguar Mbrojtjen.

1 Tani, ne mund të bëjmë një argument se kur do t'i vijë fundi
2 kësaj pune dhe kur do të mbyllet kjo çështje. Por të paktën unë kam
3 një përgjigje tani për këtë. Që është politikë e Prokurorisë, që
4 kjo ishte e gjitha që po përpiquej të bënte Prokuroria, dhe prandaj
5 i kanë bërë këto gjërat që kanë bërë deri tani. Dhe ata nuk do të
6 na e japin dosjen paraprake deri përpara -- pak përpara gjykimit në
7 qershor. Dhe prandaj edhe provat po na jepen në mënyrën sesi po na
8 jepen.

9 Sigurisht ne patëm një përmbledhje, një shënim që na u dha për
10 parakonfirmimin, por nuk është e njëjta gjë me atë që kemi kërkuar.

11 Në përgjigje të ankesës së z. Smith, që Mbrojtja po thotë që
12 është një çështje e përbërë -- e bërë prej letre. Po faktikisht
13 ashtu është, sepse po të ishte një çështje ku do të kishte një
14 akuzë kundër z. Veseli që ka vrarë këtë person, ka torturuar këtë
15 person, atëherë do ta dinim se cilat janë akuzat për të cilat duhet
16 të mbrohem.

17 Kurse tani kemi një shumësi ngjarjesh në 34 vende, të cilat po
18 hetohen si fakte primare. Dhe ne duhet të marrim me mend se çfarë
19 sugjeron Prokuroria se çfarë ka bërë filani, dhe pse një person i
20 caktuar është përgjegjës për aktet e të tjerëve, personave të
21 tjerë.

22 Në qoftë se nuk e kupton këtë Prokurori që kjo e bën shumë të
23 vështirë punën për ne si Mbrojtje, atëherë duhet të reflektojë për
24 përvojat e tij si Prokuror. Sepse është shumë e qartë që ajo që
25 duhet të bëjë Mbrojtja është shumë më e vështirë nga ajo që duhet

1 të bëjë Prokuroria.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti -- për ta mbyllur.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z. Black -- më
4 falni. Më falni, më është ngulur në mendje z. Black.

5 Pasi kam dëgjuar shpjegimet e z. Smith, që i dha këtu
6 personalisht, që unë vazhdoj të jem i mendimit se sjellja e
7 Prokurorisë është joetike, jua lë juve të hapur këtë çështje për ta
8 gjykuar.

9 Po unë jam tani i bindur se kisha të drejtë gjatë gjithë
10 kohës, dhe e shohim që Mbrojtja po përpiqet të tërhiqet në ndonjë
11 datë gjykimi që unë mendoj është e padrejtë. Dhe Prokurori e ka
12 marrë përsipër vetë të përcaktojë se çfarë është e drejtë dhe çfarë
13 nuk është e drejtë në çështjet -- në procedurat gjyqësore.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

16 Vetëm dy pika shkurt lidhur me atë çfarë u tha nga z. Smith.

17 Së pari, i nderuar Gjykatës, besoj se e dëgjuat që z. Smith
18 foli goxha në detaje që Mbrojtja në këtë moment po mundohet që të
19 vonojë procesin e gjykimit të çështjes.

20 Dhe do të doja që të theksoja fjalën "në mënyrë të
21 jashtëzakonshme" dhe do të doja që të sillja në vëmendjen tuaj sesa
22 vite ka pasur Prokuroria për ta hetuar këtë çështje. Dhe juve, i
23 nderuar Gjykatës, besoj se e kuptoni që ne thjesht duam që të kemi
24 një proces të drejtë gjyqësor, ndërkohë që Prokurori pretendon që
25 ne po kërkojmë që të vonojmë procesin gjyqësor për çështjen në

1 fjalë.

2 Sa i takon pikës së dytë që do të doja të sillja në vëmendjen
3 tuaj, kjo pikë ka të bëjë me faktin që z. Smith ngriti po ashtu
4 çështjen që Mbrojtja janë në drejtimin e duhur sa i takon
5 përgatitjes, sa i takon kësaj lënde. Pavarësisht kësaj, do të doja
6 të thosha që z. Smith nuk e ka fare idenë se në çfarë pike jemi ne
7 sa i takon përgatitjes për mbrojtjen e çështjeve tona.

8 Do të doja që t'ju kujtoja juve, i nderuar Gjykatës, do t'i
9 kujtoja dhe z. Smith që disa prej nesh sapo kanë filluar që të
10 krijojnë zyrat e tyre dhe jemi në fillimet, në fillesat fare të
11 punës për sa i takon hetimeve dhe mbrojtjes së klientëve tanë. Dhe
12 ndërkohë, ndërsa z. Smith thotë që ne jemi goxha përpara sa i takon
13 hetimeve apo proceseve përkatëse të mbrojtjes, nuk mendoj se kjo
14 ishte diçka e drejtë për t'u thënë nga ana e tij.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

16 Znj. Alagendra.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
18 Gjykatës, jam plotësisht dakord me atë çfarë u tha nga kolegët e
19 tjerë mbrojtës. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar. U thanë të
20 gjitha gjërat.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.
22 Faleminderit që ishit e shpejtë.

23 Nuk e di në qoftë se z. Prokuror doni të shtoni diçka lidhur
24 me parashtimet e Mbrojtjes?

25 Z. SMITH: [Nuk u përkthye]

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

2 Tani do të bëjmë një pushim të shkurtër prej 15 minutash. Do
3 të kthehemi sërish në sallën e gjyqit në orën 13.10 sipas orës së
4 Hagës.

5 --- Pushimi fillon në orën 12.56

6 --- Rifillon në orën 13.14

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara sesa të kalojmë në pikën
8 tjetër në agjendën tonë që ka të bëjë me hetimet e Mbrojtjes, do të
9 doja t'i bëja një pyetje ZPS-së lidhur me një çështje e cila në
10 fakt është diskutuar dhe më parë, por thjesht duam të sqarojmë
11 diçka.

12 Në çështjes që u soll në vëmendjen e Gjykatës nga znj.
13 Menegon, që ka të bëjë me nxjerrjen e informacionit për dëshmitë e
14 dëshmitarëve, në momentin kur në këto dëshmi, pra, referohen ose
15 përmenden disa dokumente. Pra, a ka mundësi që këto dokumente të
16 kenë një lidhje të qartë në Workflow, apo a ka ndonjë mundësi
17 teknike në platformën që ju përdorni në mënyrë që të mos jetë shumë
18 e ndërlikuar, le të themi, lidhja e këtyre provave me dëshmitë e
19 dëshmitarëve?

20 Në qoftë se keni nevojë për pak kohë, mund të mendoheni dhe
21 mund të më jepni përgjigje.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mendoj që kjo ka
23 të bëjë me lidhjen e Workflow-ut dhe synimi ynë është që të bëjmë
24 këtë gjë, pra, të bëjmë lidhjen ndërmjet këtyre dokumenteve.

25 Ndërkohë që disa prej këtyre provave materiale janë dokumente të

1 cilat janë diskutuar gjatë intervistimit, të cilat nuk janë nxjerrë
2 akoma sepse nuk i ka ardhur koha, dhe si rezultat d.m.th., nuk
3 është se kanë qenë pjesë e nxjerrjes, duke u mbështetur në
4 rregullën 101(2) (b) //siç u përkthye//.

5 Megjithatë, duke pasur parasysh kërkesën e Mbrojtjes do të
6 mundohemi që të bëjmë një lidhje të këtyre dokumenteve dhe dëshmime
7 të dëshmitarëve në vijim. Pra, ku është e mundur do të mundohemi që
8 të mos përdorim masat mbrojtëse, dhe kur të jetë e nevojshme
9 atëherë do të kërkojmë dhe masa mbrojtëse. Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Tani le të kalojmë te pika tjetër në agjendën e ditës së
12 sotme. Pika e radhës ka të bëjë me hetimet e Mbrojtjes. Për këtë
13 pikë do të doja së pari t'ia jap fjalë Mbrojtjes.

14 Jam i vetëdijshëm që Mbrojtja i ka filluar hetimet kohët e
15 fundit, megjithatë do të doja të dëgjoja më shumë prej secilëve
16 prej ekipeve të Mbrojtjes lidhur me hetimet, dhe në qoftë se mund
17 të na jepni ndonjë informacion të mëtejshëm lidhur me gjendjen e
18 hetimeve, apo në qoftë se mund të na jepni informacion që ka të
19 bëjë me mundësi unike investigative në përputhje me parashikimet e
20 rregullës 99(1) të Rregullores, apo në qoftë se keni ndërmend që të
21 përdorni, le të themi, parashikimet që jepen për njoftim e alibisë
22 ose shkaqeve të tjera të përgjegjësisë -- të përjashtimit të
23 përgjegjësisë.

24 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

25 Nuk mund të mos them që ndihet një lloj frakture ndërmjet ZPS-

1 së dhe pritshmërisë së Gjykatës lidhur me atë se çfarë mund të
2 bëjë, apo çfarë po bën Mbrojtja dhe realitetit. Dhe mund të them që
3 për të gjithë ne, për të gjitha grupet e Mbrojtjes, kemi një nivel
4 përvoje sa i takon realizimit të hetimeve në emër dhe për llogari
5 të mbrojtjes sonë dhe të të akuzuarve që neve përfaqësojmë.

6 Dhe në fakt, unë do të doja që të çmontoja sugjerimin që në
7 fakt po bëhet çdo gjë e mundur në mënyrë që të mund të vonohet
8 procesi gjyqësor. Ky është një keqkuptim i plotë i ZPS-së dhe nuk e
9 di se çfarë i bën ata që të mendojnë këtë gjë. Dhe me çfarë mendoj
10 dhe çfarë di unë d.m.th., është deklaruar përpara ambasadorëve dhe
11 personave të tjerë të cilët nuk janë të lidhur fare me këtë
12 çështje, dhe më duhet të them që kjo është diçka shqetësuese për
13 mua.

14 Nuk ka absolutisht asnjë lloj sugjerimi të kërkesës së vonimit
15 të proceseve gjyqësore nga ana e Mbrojtjes, dhe nuk e kuptoj se
16 çfarë fitimi mund të sillte vonesa prej nesh.

17 Dhe nuk e di sepse në fakt Prokuroria e pretendon një gjë të
18 tillë deri në masën në të cilën ajo e pretendon deri, le të themi,
19 në ndalim e përshpejtimit të realizimit të kërkesave të saj. Dhe me
20 të vërtetë nuk e di se cilat janë përpjekjet e Prokurorisë këtu.
21 Dhe nuk e di se çfarë i bën ata që të mendojnë që ne jemi të
22 interesuar për vonimin e proceseve gjyqësore.

23 Pra, përveç insistimit dhe përsëritjes, përveç se të ushtrojnë
24 ndikim te juve, nuk mendoj se ka ndonjë synim tjetër ana e
25 Prokurorisë. Megjithatë, unë mendoj që juve nuk do të bini pre e

1 kësaj.

2 Megjithatë, më lejoni të flas për elementin e radhës. Hetimet.
3 Pra, cilat janë pritshmëritë dhe cili është realiteti.

4 Personalisht do të doja të them që neve ende nuk i kemi
5 filluar hetimet. E theksoj: Ne nuk i kemi filluar përgatitjet për
6 hetime. Unë personalisht nuk i shoh hetimet që të mund të fillojnë
7 përpara prillit. Dhe mund të them se edhe në qoftë se nuk do të
8 ishte fare situata e COVIDIT, më duhet të them që do të ishte prapë
9 e vështirë. Megjithatë COVIDI në vetvete ka qenë një vështirësi, ka
10 parashtruar vështirësi shumë të mëdha për ne.

11 Nuk flitet vetëm thjesht për aksesimin ose qasjen në
12 materiale, pavarësisht vështirësive të ndryshme, pra, për të
13 krijuar vështirësi, ose le të themi, dokumentet na janë krijuar në
14 mënyrë të tillë që të krijohen vështirësi nga ana e Mbrojtjes, por
15 më duhet të them që duhet që të shikohet edhe lidhja me klientin,
16 në rastin tim z. Hashim Thaçi. Ai në fakt mezi pret që unë të vij
17 në Hagë dhe shpresoj që të mund ta bëj këtë gjë, pra, të vij në
18 Hagë nga fundi i këtij muaji.

19 Atëherë, më lejoni të them që sa i takon lidhjes ose
20 diskutimit me klientët, telefonat në ZOOM nuk funksionojnë. Neve
21 okei, jemi me -- d.m.th., bisedojmë në "chat" dhe kemi gjithashtu
22 dhe diskutime përmes ZOOM-it, megjithatë ZOOM-i nuk është i
23 mjaftueshëm për të diskutuar në detaje elementët e çështjes tonë.
24 Dhe në këtë kuadër them që COVIDI është kufizues.

25 Siç e kam përcaktuar dhe në parashtrimet që ju kam dorëzuar, i

1 nderuar Gjykatës, neve kohët e fundit, në fillim të këtij muaji
2 kemi caktuar dikë që të na ndihmojë, pra, që të funksionojë si
3 hetues parësor ose kryesor. Pra, ky është një person i cili jeton
4 në Zvicër. Ka vështirësi, por ju lutem mos mendoni qoftë edhe për
5 një moment të vetëm që ne po përpigemi nga ana e Mbrojtjes për të
6 krijuar pengesa artificiale. Nuk do të ishte shumë habi për mua në
7 këtë pikë pra, pas tre muajsh që -- ose ndoshta duke marrë parasysh
8 nxjerrjen e materialeve nga dhjetori, dhe përderisa kanë kaluar
9 vetëm dy muaj, nuk mendoj që është e panatyrshme të mendosh që ne e
10 kemi pasur të pamundur që mund të fillojmë me hetimet.

11 Unë u shpreha gabim, le të themi, në konferencën e fundit për
12 gjendjen gjyqësore. Mu desh që të shikoja transkriptin lidhur me
13 atë çfarë kisha thënë. Pra, që thashë që na duhet 18 muaj përpara
14 sesa të mund të fillonim hetimet. Pra, jam keqshprehur. Dhe e kisha
15 fjalën në fakt për fillimin e hetimeve. Por nga ana tjetër do të
16 duhet që të fillohen hetimet.

17 Megjithatë, nuk e shikoj që të kemi mundësi që t'i fillojmë
18 hetimet edhe për pak muaj në vijim. Pra, po ashtu në një çështje të
19 ngjashme, atëherë, nuk mendoj që kemi të bëjmë me mundësinë e
20 përcaktimit të hetimeve unike, ose le të themi, me alibitë dhe sa i
21 takon mbrojtjeve specifike në datë specifike. Por do të duhet që
22 pikësëpari, para sesa të bëjmë çdo gjë tjetër të kemi një vështrim
23 më të mirë, të kemi një pamje dhe një ide më të mirë të
24 dokumenteve, të provave.

25 Nuk dua të mendoj që -- nuk dua që askush të mendojë që këto

1 vonesa janë të pazakonta. Nuk janë të pazakonta. Nuk janë vonesa
2 për shkak taktike por, sipas përvojës time, d.m.th., kjo është një
3 praktike e zakonshme në një gjyq të tillë apo në një proces
4 gjyqësor të tillë.

5 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

7 Z. Krasniqi dëshiron të marrë fjalën me ç'shoh.

8 Z. Krasniqi, dëshiron të flasësh tani specifikisht apo mund të
9 presësh pak, në mënyrë që t'i japim fjalën ekipeve të tjera të
10 Mbrojtjes? Do ta marrësh patjetër tani, apo mund të presësh sa të
11 përfundojnë edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes z. Krasniqi?

12 Nuk e di në qoftë se interpretët e dëgjojnë z. Krasniqi për të
13 përkthyer.

14 Z. Krasniqi, edhe njëherë. Tani duket sikur mikrofonit sapo ka
15 filluar të punojë. Ju lutem, a e përmend edhe njëherë nga fillimi,
16 na e thuaj dhe njëherë nga fillimi çfarë po thoshe në mënyrë që të
17 mund ta dëgjojmë çfarë thatë.

18 I AKUZUARI KRASNIQI: [Përmes videolidhjes] Po. Unë e kam një,
19 si të them, reagim në fjalën e Prokurorit, z. Smith, kur foli në
20 emër të popullit të Kosovës.

21 Në emër të qytetarëve të Kosovës, në emër të popullit të
22 Kosovës mund të flasim ne përfaqësuesit e tij. Unë 45 vjet të jetës
23 sime i kam të angazhuar për liri, për drejtësi dhe për çlirimin e
24 kombit tim nga robëria.

25 Nga viti në vit, në zgjedhjet e vitit 1992 kam qenë i zgjedhur

1 deputet në Kuvendin e Kosovës që regjimi kriminal i Serbisë nuk e
2 kanë lejuar që të konstituoet. Pas luftës çlirimtare kam qenë në të
3 gjitha legjislaturat deri në legjislaturën e vitin 2014,
4 përfaqësues i qytetarëve të Kosovës.

5 Dhe e kisha lutur Prokurorin nëse ai duhet të fletë në emër të
6 dikuj, ose duhet të fletë në emër të krimeve të pretenduara, ai le
7 të bëhet mbrojtës i politikave të krimit dhe të gjenocidit që
8 regjimi i Serbisë ka përdorur gjatë kombit tim prej nga viti 1876,
9 1878, të shekullit XIX.

10 Prandaj, në emër të popullit tim, në emër të kombit tim dhe në
11 emër të luftës dhe të sakrificave të mëdha të kombit tim, flasim ne
12 përfaqësuesit e tij dhe jo ata që tentojnë ta dënojnë luftën
13 shumëvjeçare të kombit tim, e në mënyrë të veçantë, luftën e fundit
14 të popullit tim për liri, për drejtësi, për barazi dhe për
15 shtetndërtim.

16 Për çka kombi ynë dhe neve e kemi fituar mbështetjen
17 ndërkombëtare, e kemi çliruar Kosovën, dhe Kosova sot është shtet i
18 pavarur dhe i lirë nga ai regjim.

19 Unë këtë desha ta them edhe këtu po e mbylli fjalën time.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të faleminderit shumë z.
21 Krasniqi.

22 Tani vazhdojmë me çështjen që po diskutonim. Do të doja t'i
23 jepja fjalën z. Emmerson pa vonesë.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
25 nderuar Gjykatës.

1 Siç e dini, ne kemi një skuadër për hetime që është në pritje
2 dhe në fakt është angazhuar kjo skuadër që prej datës 1 janar. Dhe
3 sa i takon kërkesës për lirim paraprak, siç mund ta keni vënë re,
4 ne kemi qenë në gjendje që t'i përgjigjeshim shumë shpejt disa prej
5 akuzave në emër të z. Veseli.

6 Pra, me fjalë të tjera po mundohem t'ju them që skuadra është
7 e ndërtuar, është e pranishme. Megjithatë, problemi është, siç u
8 tha edhe nga z. Hooper, që ne nuk jemi në pozicion që t'iu themi
9 atyre se çfarë duhet të hetojnë posaçërisht ose ekzaktësisht ata.
10 Dhe kjo në vetvete na çon te një tjetër çështje që e ngriti me
11 shumë të drejtë edhe shumë mirë formuluar z. Hooper, që ne sapo
12 dëgjuam z. Krasniqi që i bëri thirrje z. Smith, që të mos fliste në
13 emër të popullit të Kosovës --

14 Por në të njëjtën kohë do t'i kërkoja Prokurorit, siç tha dhe
15 z. Hooper, që të ndalojë pretendimet dhe akuzat që ne po mundohemi
16 që të vonojmë proceset gjyqësore.

17 Pra, në fillim, ne duam që -- ky do të ishte si një mjet për
18 të siguruar lirimin me kusht, por kjo tashmë nuk është më. Nuk
19 është më ky rasti sepse, siç e dimë, të akuzuarit tanë janë të
20 ndaluar. Kështu që është në interes të drejtësisë që ky proces
21 gjyqësor të mund të realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe
22 të akuzuarit të kenë mundësi që të vetëmbrohen.

23 Kështu që, ideja që të katër të akuzuarit janë të ndaluar, dhe
24 ideja që avokatët mbrojtës po mundohen që të vonojnë sa më shumë të
25 jetë e mundur zgjidhjen e çështjes, ose shqyrtimin e çështjes dhe,

1 siç e tha edhe z. Hooper, kjo nuk është një strategji e cila tashmë
2 nuk qëndron asgjëkundi.

3 Pra, e dëgjuam z. Smith që ta artikulonte këtë gjë, dhe
4 mendojmë që mënyra më e mirë për hartimin dhe për trajtimin e këtij
5 procesi, sipas z. Smith, ishte që ne të mos na jepesh informacioni,
6 dokumentacioni deri në momentin e fundit. Dhe më duhet të them që
7 kjo nuk është se ne nuk po bëjmë asgjë. Por data më e hershme kur
8 kemi mundësi që ne të japim -- që të fillojmë procesin e hetimit
9 është që së pari të kemi mundësi që të përtypim -- që të marrim
10 vesh informacionin nga Prokuroria në mënyrë që të shmangim procesin
11 e analizës së dyfishtë që unë e përmenda pak më përpara.

12 Ndërkohë, siç e tha dhe z. Hooper, unë mendoj që fillimi i
13 majit do të ishte një datë e arsyeshme, ose si një objektiv që unë
14 mund të njoftoja fillimin, nisjen e hetimeve. Pra, mendoj që do të
15 jemi në gjendje që të fillojmë dy javët e para të majit me këtë
16 proces.

17 Por, ashtu siç u tha nga z. Hooper, dhe dua ta theksoj që kjo
18 nuk është për asnjë arsye teknike por e kemi pasur të pamundur që
19 të fillojmë procesin e hetimeve. Në qoftë se do të përfshijmë këtu
20 hetimet që kanë të bëjnë me lirimin e përkohshëm, atëherë mund të
21 thuash që Mbrojtja është në fazat e hershme të hetimit. Por në të
22 kundërtën kjo nuk është e vërtetë sepse ne ende nuk e kemi filluar
23 procesin e hetimit, sepse Prokuroria vijon që të insistojë që të
24 mos na e japë informacionin e duhur. Dhe na është dashur që këtë
25 proces ta bëjmë vetë d.m.th., përpara sesa të fillohet hetimi.

1 Më lejoni të them që komentet që u bënë nga z. Smith sot
2 paradite --

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Nuk u përkthye]

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju kërkoj
5 ndjesë. Ju kërkoj ndjesë që e them gabim emrin e z. Smith. Ju
6 kërkoj ndjesë.

7 Atëherë, lidhur me atë çfarë na tha z. Smith sot paradite, të
8 paktën ai -- të paktën ka filluar që të na japë një shpjegim lidhur
9 me pozicionimin tonë. Në fakt, ai ka provuar që dyshimet e
10 Mbrojtjes ishin të bazuara dhe pozicionimin tonë për mënyrën shumë
11 të çuditshme sesi janë realizuar proceset deri tani. Dhe objekti
12 kryesor i Prokurorisë ishte që të pengohet, le të themi, procesi
13 hetimor, ose puna përgatitore e avokatëve mbrojtës sa më shumë të
14 ishte e mundur.

15 Këtë gjë na e bëri të ditur vetë z. Prokuror. Dhe kjo në
16 vetvete, siç e thashë dhe më përpara, është një hap goxha i
17 rëndësishëm përpara sepse do të na bëjë ne të mundur që të kemi më
18 shumë parashikueshmëri dhe tani ne e kuptojmë se kush është parimi
19 që udhëzon punën e Prokurorisë. Kjo është një mënyrë shumë e mirë e
20 të shprehurit sepse -- unë në fakt të them, që drita e diellit
21 është dezinfektuesi më i mirë. Dhe në fakt situata është e qartë
22 fare tani më. Dhe d.m.th., Prokuroria tashmë e ka shumë të qartë,
23 le të themi, pozicionin e vetë, ndërkohë që i takon Gjykatës që të
24 përcaktojë se çfarë është e nevojshme për procesin e drejtë
25 gjyqësor dhe jo për Prokurorinë.

1 Dhe në këtë moment dëgjuam që Prokuroria tha që, le të themi,
2 burimet e tyre janë të kufizuara dhe thanë gjithashtu që për arsye
3 të mbrojtjes së dëshmitarëve, ata kanë si synim që të vazhdojnë me
4 procedurën e tyre të ofrimit të dokumenteve.

5 Në përmbyllje më lejoni të them që parashikohet nga ana jonë
6 që ne të fillojmë me pjesën e hetimit nga dy javët e para të majit.
7 Megjithatë, edhe kjo datë mbështetet fort te pjesa e nxjerrjes së
8 informacionit që do të na vihet në dispozicion nga Prokuroria dhe
9 nga dosja paraprake që do të marrim prej tyre.

10 Jam takuar me mbikëqyrësin tim ndërkombëtar, dhe më duhet të
11 them që unë aktualisht nuk shkoj dot fare në Kosovë. Sepse do të
12 ishte qesharake në qoftë se nuk do të merrnim parasysh situatën dhe
13 rrethanat e krijuara nga COVIDI. Deri në momentin kur vaksinat e
14 shpërndara në Kosovë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, deri në momentin
15 kur ato mund të arrinin një kufi të arsyeshëm. Për momentin është e
16 pamundur që unë të udhëtoj drejt Kosovës. Dhe jo vetëm kaq, po edhe
17 nuk ka pikë vlere që unë të shkoj në Kosovë sepse nuk e kemi marrë
18 akoma dosjen paraprake të çështjes.

19 Kështu që për këtë arsye është e rëndësishme që së pari të
20 marrim dosjen dhe pastaj të vijojmë me hetimet. Nuk i takon
21 Prokurorisë që të përcaktojë se çfarë është një proces i rregullt
22 ligjor, por i takon Gjykatës që të marrë një vendim të tillë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

24 Z. Young, fjala për juve.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe unë pajtohem

1 me parashtimet e z. Hooper dhe Emmerson.

2 Do të ishte shumë e parakohshme që të flasim hapur për këtë.
3 Faktet varen -- situata varet nga situata, nga fondet, nga burimet.
4 Unë supozoj që fondet do të jenë të disponueshme, pastaj vjen puna
5 te leximi, kuptimi i dosjes së Prokurorisë që kërkon muaj. Kështu
6 që aq muaj saç ka pasur edhe, të themi, Prokuroria, me qëllim që të
7 bëjmë gjykime të përshtatshme profesione lidhur me atë që duhet të
8 hetojmë.

9 Do të ishte tepër e parakohshme që të angazhohemi në një
10 diskutim konstruktiv lidhur me këtë çështje tani.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

12 Znj. Alagendra.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe ne i
14 bashkëngjitemi kolegëve.

15 Gjithashtu vonesa e marrjes së përkthimeve në rastin tonë
16 është më e madhe sepse z. Krasniqi nuk flet apo lexon anglisht, gjë
17 që ka ndikuar në fillimin e hetimeve për ekipin tonë të Mbrojtjes.
18 Ai do të jetë në gjendje të plotë të japë udhëzimet e tij pasi t'i
19 ketë marrë përkthimet shqip dhe t'i ketë lexuar e studiuar. Deri
20 atëherë nuk do të jemi në gjendje të fillojmë plotësisht hetimet
21 tona.

22 Dhe gjithashtu nuk mund të japim ndonjë përditësim të
23 rëndësishëm lidhur me mundësitë për -- apo alibinë për hetime në
24 këtë moment.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.

1 Alagenda.

2 Z. Roche nga Zyra e Administratës, do t'ju lutesha të shikoni
3 mundësinë e udhëtimeve sidomos në Kosovë. E di që ka kufizime në
4 disa vende për të ardhur në Holandë apo për të shkuar në Kosovë.
5 Por a mund të na thoni se cilat janë marrëveshjet e arritura nga
6 institucioni ynë me qëllim që avokatët të shkojnë në Kosovë?

7 Z. ROCHE: [Përkthim] Si mbajtës të kartave diplomatike të
8 Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe me privilegjet dhe imunitetet
9 që ajo gëzon, ata nuk i nënshtrohen asnjë -- ndonjë ndalimi për të
10 udhëtuar. Nuk mund të japim për këtë moment ndonjë hollësi të
11 mëtejshme, po mund t'ia japim avokatëve sigurisht.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

13 Po i kthehem Prokurorisë. A keni ju ndonjë parashtim lidhur
14 me parashtimet që bëri Mbrojtja?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të flas shkurt.

16 Ligji për rregulloren përcakton rregulla të qarta lidhur me
17 nxjerrjen e materialeve dhe detyrimet tona dhe ne iu përmbahemi
18 atyre. Ato që u thanë për sa i takon nxjerrjes së materialeve dhe
19 për atë që Mbrojtja kërkon përtej atyre që ne duhet të japim.

20 Materiali i paraqitur Mbrojtjes i është dhënë në të njëjtën
21 mënyrë siç ia kemi dhënë Trupit Gjykses. Politika e ZPS-së është që
22 afati i nxjerrjes së dokumenteve të jetë në përputhje me rregullat
23 ndërkombëtare të nxjerrjes së materialeve në çështje të ngjashme.

24 Lidhur me punën e madhe që ka bërë ZPS-ja, që e kemi paraqitur
25 këtu apo në konferenca të tjera, është e qartë se megjithëse janë

1 dhënë materiale ata nuk kanë filluar asnjë lloj hetimi.

2 Në vend që të uzurpojmë funksionet e Trupit Gjykues, ne si
3 Prokurori po japim parashtrime të informuara dhe të hollësishme për
4 të ndihmuar Trupin Gjykues në vlerësimin e tij.

5 Për sa i takon kohës së dorëzimit të dosjes paraprake që
6 përmendi z. Emmerson, ai përmendi TPNJ-në, po e referoj në
7 paragrafin 15 të parashtrimeve me gojë tonat të paraqitura në
8 Konferencën për Ecurinë e Çështjes.

9 Në këtë rast data që ZPS-ja ka vënë në dukje është data më e
10 hershme e mundshme kur ne mund të paraqesim këtë dosje duke punuar
11 fuqimisht.

12 U përmend COVIDI. Nuk mund ta them kurrësi që nuk është një
13 sfidë e madhe për të gjithë, por progresi duhet të bëhet dhe duhet
14 të vazhdojë. Ka mënyra të ndryshme për të punuar që Zyra e
15 Administratës i vuri në dukje dhe ne duhet t'i përshtatemi. ZPS-ja
16 ka parashtruar aktakuza, ka bërë shumë operacione dhe do të
17 vazhdojë të bëjë intervista. Ka mënyra për të punuar dhe ne e
18 inkurajomë Mbrojtjen që t'i ndjekë këto mënyra.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

20 Ka njeri nga Mbrojtja që dëshiron të marrë fjalën?

21 Z. Hooper, ju lutem. Mikrofonin? Mikrofonin, ju lutem.

22 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dua të vë në dukje
23 dy çështje që mund të duken mbase të parëndësishme.

24 Por, së pari, nuk e di nëse ndonjëri nga Prokuroria është
25 marrë me një çështje të Mbrojtjes? Nuk më duket se ndonjëri prej

1 tyre është marrë me aspektin e mbrojtjes së një çështjeje, sepse
2 kjo lidhet me rolin e Mbrojtjes dhe me punën që duhet të bëjë
3 Mbrojtja.

4 Mendoj që në situata normale në një fazë të tillë çështjeje si
5 kjo e jona, unë duhet të kisha vajtur në Kosovë, jo vetëm për t'u
6 familjarizuar me aspektet e punës që është një aspekt i rëndësishëm
7 kur fillon një çështje -- për këto arsye unë s'e kam bërë.

8 Jam i sigurt që dokumenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme që
9 përmendi përfaqësuesi i Zyrës Administrative është mjaft i dobishëm
10 sepse i imi po pret në Londër, por nuk na mbron nga COVIDI dhe ky
11 është një shqetësim. Sidomos kur po lexoja sot English Times. Ata
12 kanë zbuluar një mutacion të ri që është një bashkim i mutacionit
13 anglez dhe atij të Afrikës së Jugut. Pra, nuk besoj që kemi mbaruar
14 me COVIDIN.

15 Por sigurisht që jam shumë i gëzuar që e kam marrë këtë
16 dokumentin para një apo dy javësh sepse më jep një besim më të madh
17 për t'u angazhuar me hetimet që më presin. Dhe shpresoj që do ta
18 bëj këtë sa të jem në gjendje ta bëj.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

20 Z. Emerson.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dua të flas dhe
22 unë për këtë pikën e fundit.

23 Nuk është çështja e kartës diplomatike. Ju e dini nga
24 korrespondenca jonë e mëparshme se unë nuk jam në gjendje të
25 udhëtoj gjatë pandemisë për arsye shëndetësore. Jam një prej disa

1 njerëzve që janë në këtë gjendje.

2 Edhe pse situata është kjo që është në Kosovë, plus që janë
3 mbajtur dhe zgjedhjet kohët e fundit, dhe njerëzit kanë qenë në
4 kontakte më të ngushta në ambiente të mbyllura, por procesi i
5 vajtjes në Kosovë dhe i bisedimeve, takimit të hetuesve në terren
6 është shumë i vështirë. E dimë që mund ta eliminojmë këtë pengesë
7 duke bërë videokonferenca, por gjithsesi ky është një diskutim
8 akademik.

9 Ne e dimë që duhet të bëjmë hetimet tona. Asnjë mbrojtës i
10 përgjegjshëm nuk do të rrinte në zyrë dhe do të lexonte vetëm
11 dokumente. Nuk bëhet puna kështu. Së pari, duhet të analizojmë
12 provat, dëshmitë me hollësi, t'i analizojmë ato sepse do të merremi
13 për kërkesat për -- që u morëm me kërkesat për lirimin e
14 përkohshëm, e për gjëra të tjera.

15 Njëkohësisht, procesi i përpunimit të dëshmive kërkon shumë
16 kohë sepse Prokuroria, siç e dimë tashmë, ndjek politikën e dhënies
17 së materialeve pak nga pak dhe brenda një kohe sa më të shkurtër.
18 Kështu që unë nuk do të shpenzoj para dhe burimet pa ditur -- për
19 hetime pa ditur se cila do të jetë çështja e Prokurorisë.

20 Prandaj ju lutem juve, që t'i drejtoheni Prokurorisë pra, për
21 dorëzimin e dosjes. Prokuroria e ka draftin. Mund të mos jetë i
22 përsosur, mund ta redaktojnë, mund ta rregullojnë, dhe mund ta
23 paraqesin me qëllim që gjykimi të fillojë në kohën e duhur. Në
24 qoftë se nuk zgjidhet kjo, edhe pas nëntë muajsh do të kemi të
25 njëjtën -- do të zhvillojmë të njëjtën bisedë që po zhvillojmë sot.

1 Me respekt po ju drejtohem, ju duhet ta merrni situatën në
2 dorë. Duhet të jepni urdhër që të na jepet dosja paraprake në
3 prill, sepse të gjithë, qoftë Mbrojtja, qoftë Prokuroria dhe
4 drejtësia do që ky gjykim të shihet si një proces i rregullt. Kur
5 Prokuroria e ka nisur punën me këtë politikë që po e shpalos këtu
6 për të kufizuar aftësinë e Mbrojtjes për të përgatitur mbrojtjen e
7 vetë, është, pra, siç thashë, në dorën tuaj që ta drejtoni kursin e
8 punës, e procedurave këtu për të bërë një punë të mirë
9 profesioniste dhe për t'i treguar komunitetit ndërkombëtar se kjo
10 Gjykatë e meriton mandatin që i është dhënë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

12 Nuk shoh ndonjë pjesëtar tjetër të Mbrojtjes të kërkojë
13 fjalën.

14 Do të kalojmë në pikën e fundit të programit sot që ka të bëjë
15 me pikat e marrëveshjes për çështje ligji dhe fakti.

16 Pra, a mund të më konfirmoni se keni ardhur në pikën e
17 marrëveshjeve për çështje të ligjit dhe të faktit?

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po përgjigjem shumë shkurt lidhur me
19 ato që u thanë për pikën para kësaj.

20 Mbrojtësi i z. Thaçi vuri në dyshim nëse neve e kemi prodhuar
21 -- përgatitur çështjen tonë. Ju siguroj që e kemi përgatitur. Po i
22 rikthehem Mbrojtjes së Veselit ta rishikojë dhe njëherë afatin
23 kohor për dosjen paraprake në çështjen Haradinaj.

24 Jemi në një fazë të avancuar brenda vetes lidhur me
25 përgatitjen e një propozimi dhe parashikojmë që do t'ia japim për

1 shqyrtim Mbrojtjes shpejt.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

3 Emmerson, shumë shkurt ju lutem.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Për një çështje
5 fakti që vazhdimisht ngrihet lidhur me dosjen paraprahe në çështjen
6 Haradinaj.

7 Me sa shoh nuk e ka kuptuar Prokurorja faktin që akuza në
8 rastin Haradinaj është një aktakuzë narrative. Me fjalë të tjera,
9 të mundëson të kuptosh se çfarë pretendohet dhe përse. Dhe kjo nuk
10 është praktika e Prokurorisë të ndjekur në këtë çështje. Kjo është
11 ndjekur në çështjen e TPNJ-së. Prandaj duhet që informacionin ta
12 kemi, siç thashë, me hollësi përpara se të fillojmë.

13 Pra, ishte një -- atëherë aktakuza ishte shumë përshkruese e
14 me hollësi, gjë që nuk ka ndodhur. Prandaj kërkojmë dosjen
15 paraprahe nga ana e Prokurorisë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper, keni ndonjë gjë për
17 të thënë lidhur me faktet e rëna dakord me Prokurorinë?

18 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po. Jam
21 mirënjohës për gjithçka që na japin. Nuk mund t'ju përgjigjemi
22 sigurisht, pa bërë dhe ne hetimet tona.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

24 Z. Young.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë për

1 të thënë. Presim që të marrim dosjen.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe ne do
4 t'i përgjigjemi si duhet pasi të kemi parë propozimin.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.

6 Tani dua t'i pyes palët për një datë të përshtatshme për
7 Konferencën e ardhshme për Ecurinë e Çështjes.

8 Znj. Prokurore.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua ta bëj të qartë se aktakuza jonë
10 si Prokurori është një aktakuzë narrative. Ka rreth 50 faqe. Dhe
11 përveç aktakuzës, ekipi i Mbrojtjes ka marrë edhe përshkrimin në
12 bazë të rregullës 86(3)(b), që nuk është ofruar në asnjë
13 institucion tjetër.

14 Për sa i takon Konferencës për Statusin e Çështjes, neve
15 inkurajojmë vazhdimin e mbikëqyrjes aktive të procesit paragjyqësor
16 dhe do ta mirëprisnim një konferencë të tillë në fillim të marsit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Hooper.

19 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Është në
20 përgjithësi?

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, është për datën e
22 konferencës tjetër.

23 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kërkohet kohë
24 sepse duhet përgatitur. Dhe nuk e di nëse duhet që t'i mbajmë këto
25 konferenca çdo katër javë? Mbase do të ishte më mirë çdo gjashtë

1 javë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I kuptoj të dyja
4 mendimet, por për momentin duhet një -- ka nevojë për një ndërhyrje
5 të fortë gjyqësore për t'u siguruar që procesi të vihet në rrugën e
6 duhur. Prandaj edhe unë jam me Prokurorinë që të mbahet një
7 konferencë tjetër në fillim apo në mes të marsit.

8 Nuk e di se kur ju do të vendosni lidhur me dosjen
9 paragjyqësore të Prokurorisë, por gjithsesi për sa kohë që
10 Prokuroria po i shmanget rrugës së drejtë, duhet që t'i kemi, t'i
11 mbajmë këto konferenca, me qëllim që ata që i ndjekin procedurat të
12 shohin se Prokuroria, nuk po e udhëheq ajo procesin por e kundërta,
13 Trupi Gjykses.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Young.

16 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mesi i marsit do të
17 ishte me vend.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kurdo që juve
20 ta shihni me vend.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pika tjetër -- konferenca tjetër do të parashikohet në kohën e
23 duhur dhe do të merrni si gjithmonë programin e saj.

24 I ftoj palët të bëjnë parashtime me shkrim në goftë se duan
25 të ngrenë ndonjë çështje në konferencën e ardhshme.

1 Tani i pyes palët, a keni ndonjë çështje tjetër që doni të
2 ngrini?

3 Nëse ndonjë nga parashtrimet tuaja kërkon nxjerrjen e
4 informacionit konfidencial, ju lutem viheni në dukje.

5 Mora shënim parashtrimin e z. Hooper, se çështja e dhënies së
6 materialit për të akuzuarit po zgjidhet, do të zgjidhet plotësisht
7 shumë shpejt.

8 Znj. Prokurore, ndonjë çështje tjetër që doni të ngrini?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, faleminderit. Asgjë nuk kemi.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Hooper.

12 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dua të them diçka
13 pozitive lidhur me Dhomat e Specializuara. Falënderoj Zyrën e
14 Administratës që na ka ndihmuar vazhdimisht sa herë që ne kemi
15 kërkuar diçka apo kemi bërë ndonjë kërkesë.

16 Në lidhje me Zyrën e Administratën, ne e kemi ngritur me këtë
17 zyrë vështirësinë që kemi për marrjen e materialeve që përmendëm.
18 Ndërkohë dhe me sa kuptoj, Zyra e Administratës po vendos një
19 lidhje, në rastin tim, midis z. Thaçi dhe Zyrës së Mbrojtjes, e
20 cila na është dhënë këtu në Hagë. Nuk dua të them më shumë se kaq
21 për momentin për këtë çështje, por me sa kuptoj është e kufizuar
22 vetëm për dokumente. Por kjo tregon që mund të hidhen dokumentet,
23 të vihen në kompjuter dhe t'i bëhen të njohura klientit.

24 Është një sistem që përdoret në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.
25 Është një gjë e mirë dhe e falënderoj Zyrën e Administratës për

1 reagimin e shpejtë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

3 Z. Emerson.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në qoftë se më
5 lejoni, dua që dhe unë të mbështes komentet e z. Hooper, jo vetëm
6 e ndihmën e Zyrës së Administratës për dokumente, por ne kemi pas
7 një marrëdhënie të shkëlqyer me të. Përveç marrëdhënies me
8 Prokurorinë që e vura në dukje lidhur me dosjen paraprake, ndryshe
9 jemi të kënaqur me marrëdhënien pra, që kemi me Zyrën e
10 Administratës që ka bërë gjithçka që ka mundur që Mbrojtja të marrë
11 ndihëm e duhur.

12 Pika e dytë, është në fakt një pyetje. Ju thatë që përpara
13 konferencës së ardhshme dëshironi të merrni parashtime me shkrim
14 për çdo pikë që ne do të donim të përfshinim në program apo
15 agjendë. Ne ju kemi kërkuar që të jepni urdhër që dosja paraprake
16 të dorëzohet më 1 prill. Ju i dëgjuat parashtimet e të dy palëve.

17 Dhe më duket sikur u shqyrtua si duhet tërësisht dhe ju mund
18 të merrni vendim. Por sigurisht që ju mund të keni një mendim të
19 ndryshëm dhe do ta vini në dukje mbase në konferencën tjetër. Do të
20 preferoja shumë që kjo çështje të vendosej tani, që ne pas një
21 muaji të kemi një konferencë sa më të efektshme dhe jo të vazhdojmë
22 përsëri të diskutojmë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

24 Është absolutisht e saktë. Unë e kisha fjalën nëse doni të
25 ngrini ndonjë çështje të re që nuk është diskutuar sot apo në

1 konferencën e mëparshme. Nuk kisha parasysh këto që janë diskutuar
2 sot në mënyrë të hollësishme që është një gjë shumë e mirë.

3 Z. Young.

4 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam gjë për të
5 shtuar. Faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra, ju lutem.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] As unë s'kam
8 gjë për të shtuar, përveç mirënjohjes për Zyrën e Mbrojtjes dhe të
9 Administratës që na ka ndihmuar kaq shumë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit që ia
11 thatë këto fjalë Zyrës së Administratës që e meriton plotësisht.

12 Përpara se të përfundojmë seancën e sotme, dua të organizojmë
13 çështje lidhur me ndalimin, paraburgimin duke dhënë këtë urdhër:

14 Ekipet mbrojtëse përkatëse do të japim parashtrimet e tyre
15 deri të premten nëse vazhdojnë të ekzistojnë arsyet për vazhdimin e
16 paraburgimit; përgjigjet e këtyre parashtrimeve do të ndjekin
17 afatet kohore të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

18 Faleminderit ekipit të Mbrojtjes që e ka dërguar linkun e
19 videokonferencës 24 orë përpara. Në të ardhmen, njoftimet lidhur me
20 përdorimin e videolinkut nuk duhet t'i dërgoni te unë.

21 Korrespondenca me Zyrën e Administratës që përfshin një formular
22 pëlqimi do të mjaftonte.

23 Me kaq përfundojmë seancën e sotme. Falënderoj palët,
24 administratën, përkthyesit për fleksibilitetin e tyre lidhur me
25 kohën, stenografët dhe teknikët, punonjësit e sigurimit.

1 Me kaq përfundojmë.

2 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundoi
3 në orën 14.00

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25